

Raporti vjetor për punën e
Komisionit për
Parandalimin dhe Mbrojtjen
nga Diskriminimi për vitin
2022

Përmbajtja

Rezyme.....	4
Organika, kompetencat ligjore dhe përbërja e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi	6
Kudri ligjor.....	6
Anëtarët e KPMD-së.....	7
Shërbimi profesional.....	8
Statusi i implementimit të kompetencave të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi	10
Parashtesa dhe procedura për mbrojtjen nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare.....	10
Të dhëna demografike për parashtruesit e parashtresave.....	11
Fushat e denoncuara të diskriminimit.....	14
Bazat e denoncuara të diskriminimit.....	18
Vendimmarrja e Komisionit lidhur me parashtesat dhe procedurat e iniciuara për mbrojtje nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare.....	23
Diskriminim i konstatuar në vitin 2022.....	24
Bazat e diskriminimit në rastet e konstatuara në vitin 2022.....	25
Fushat e diskriminimit në rastet e konstatuara në vitin 2022.....	26
Diskriminimi në fushën e informimit publik dhe medias.....	27
Diskriminimi në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës.....	29
Diskriminimi në fushën e qasjes në të mira dhe shërbime.....	30
Diskriminim në fushën e sigurimit social, duke përfshirë edhe sferën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen shëndetësore.....	32
Raste të diskriminimit u konstatuan në dy fusha.....	33
Rekomandime të përgjithshme.....	34
Rekomandimi i përgjithshëm i cili i adresohet vetëqeverisjes lokale që të sigurojë qasje të barabartë në ujë për të gjithë qytetarët me fokus të veçantë mbi komunitetin etnik rom.....	34
Rekomandimi i përgjithshëm për eliminimin e segregacionit në arsimin fillor me fokus të veçantë mbi nxënësit romë, kështuqë në mënyrë konsekuente do të respektohen aktet e rajonizimit në komuna gjatë regjistrimit të nxënësve në shkollat fillore.....	35
Statusi i përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit.....	36
Kërkesa për iniciimin e procedurave për kundërvajtje.....	36
Opinione profesionale.....	37

Opinionimi profesional për terminologjinë e përdorur në materialin për arsimin formal, kapitulli i përgatitur nga teksti shkollor Stomatologjia pediatrike, me titull Mbrojtja dentare e fëmijëve me aftësi të kufizuara.....	37
Opinionimi profesional për Propozim-Ligjin për nëpunësit administrativë i postuar në Regjistrin Unik Elektronik Kombëtar të akteve normative (RUEK) – Tetor 2022.....	38
Pjesëmarrja e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi si "mik i gjykatës" (amicus curiae) në procedurën gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi me interes publik (actio popularis).....	40
Aktivitetet e realizuara të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi.....	41
Konferenca e 6-të Rajonale e Organeve të Barazisë në Evropën Juglindore.....	41
Kontribut në konsultat e Komisionit Evropian lidhur me standardet e Organeve të Barazisë.....	42
Raportimi dhe avokimi ndërkombëtar.....	42
Kontributi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Raportin e 4-të ndaj Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.....	42
Ditët e Hapura të KPMD-së për Barazi dhe Mosdiskriminim.....	42
Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.....	43
Fuqizimi i kapaciteteve të KPMD-së.....	45
Prezenca e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi në media.....	46
Buxheti, llogaria përfundimtare dhe financimi.....	47
Anekse.....	49
Aneksi 1: Pasqyra tabelare e rasteve të konstatuara të diskriminimit sipas fushave, llojeve dhe bazave të diskriminimit.....	50
Aneksi 2: Raste të veçuara nga praktika.....	53
Aneksi 3: Llogaria përfundimtare.....	62

Rezyme

Me këtë Raport pasqyrohen arritjet dhe aktivitetet e realizuara të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMD) në vitin 2022.

Në vitin e dytë të themelimit, KPMD-ja vazhdoi të etablohet si një autoritet profesional, i pavarur dhe autonom, një aktor relevant, kredibël dhe i respektuar në shoqërinë maqedonase sa i përket luftës kundër pabarazisë dhe eliminimit të të gjitha llojeve të diskriminimit.

Qytetarët dhe organizatat vazhduan të parashtrojnë parashtrësia pranë KPMD-së në një vëllim akoma më të lartë, duke kërkuar mbrojtje nga diskriminimi në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Deri më 31 dhjetor të vitit 2022, janë parashtruar 248 parashtrësia, si dhe janë iniciuar 7 procedura për mbrojtjen nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare. Diskriminim është konstatuar në 70 raste, nga të cilat 23 raste si forma më të rënda, përkatësisht diskriminim i shumëfishtë, i përsëritur, i zgjatur dhe ndërsektorial. Komisioni, veç tjerash, miratoi edhe dy rekomandime të përgjithshme në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit. U miratuan edhe dy opinione profesionale, njëri prej të cilëve kishte të bëjë me terminologjinë e përdorur në materialin e arsimit formal, dhe i dyti për një propozim-ligj.

Në rastet e diskriminimit të verifikuar në vitin 2022, u konstatua shkelja e së drejtës së barazisë në 22 baza të ndryshme (të gjitha përveç bazës së "shtetësisë") edhe atë në fushat si vijon:

- 37 në fushën e informimit publik dhe medias
- 15 në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës
- 10 në fushën e qasjes në të mira dhe shërbime
- 6 në fushën e arsimit
- 2 në fushën e sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore
- 1 në fushën e sportit
- 1 në fushën e veprimtimit të shoqatave, fondacioneve ose organizatave të tjera në bazë të anëtarësisë

Për shkak të mosveprimit ndaj rekomandimeve të Komisionit, u paraqitën 14 kërkesa për iniciimin e procedurave për kundërvajtje kundër diskriminuesve të caktuar, nga të cilat për 9 kërkesa, gjykatat kanë iniciuar procedura për kundërvajtje. Në vitin 2022, u nxor aktgjykimi i parë me të cilin gjykata dënoi një diskriminues sipas kërkesës së paraqitur nga KPMD-ja.

Në periudhën raportuese, Gjykata Civile në Shkup nxori aktgjykim të shkallës së parë sipas padisë me interes publik, me të cilin u konstatua diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara, sa i përket qasjes së tyre në vendet zgjedhore. Kjo është procedura e parë gjyqësore në të cilën Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi e përdori institutin "mik i gjykatës" (amicus curiae) dhe kontribuoi në rrjedhën e procedurës.

Raporti vjetor i KPMD-së për vitin 2022 ofron një pasqyrë edhe për statusin, udhëheqsinë, kompetencën dhe strukturën organizative të Komisionit, aktivitetet e realizuara për përmirësimin e cilësisë së punës, bashkëpunimin e realizuar me institucionet dhe organizatat e tjera nga vendi dhe jashtë tij.

Organika, kompetencat ligjore dhe përbërja e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kuadri ligjor

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi u themelua me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 258/2020, datë 24 tetor 2020) si autoritet i pavarur dhe i mëvetësishëm me cilësi të personit juridik. Me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, KPMD-së iu dhanë kompetenca të reja dhe të zgjeruara në aspektin e punës dhe kompetencave që janë paraparë me Ligjin e mëparshëm për mbrojtjen nga diskriminimi, i cili tani më nuk është në fuqi.

Në nenin 21 të Ligjit përcaktohen kompetencat e KPMD-së, si vijon:

- ndërmerr aktivitete për promovim, mbrojtje dhe parandalim, për barazi, për të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminim;
- e mbikëqyr zbatimin e ligjit dhe ofron opinione dhe rekomandime të veta;
- e promovon parimin e barazisë, të drejtën e mosdiskriminimit dhe luftimin e të gjitha formave të diskriminimit përmes rritjes së ndërgjegjësimit, informimit dhe edukimit publik;
- kontribuon në hartimin dhe implementimin e programeve dhe materialeve në fushën e arsimit formal dhe joformal;
- harton dhe publikon raporte të veçanta dhe tematike për çështje të caktuara në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit;
- bën rekomandime të përgjithshme për çështje të caktuara në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe e mbikëqyr zbatimin e tyre;
- angazhohet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare bilaterale ose multilaterale nga fusha e të drejtave të njeriut ose për aderimin në të njëjtat, si dhe e mbikëqyr implementimin e tyre;
- kontribuon në hartimin e raporteve, të cilat shteti e ka detyrim t'ua paraqesë autoriteteve ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut dhe kontribuon në zbatimin e rekomandimeve të tyre;
- e promovon dhe propozon harmonizimin e legjislacionit, akteve normative dhe praktikave kombëtare me instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut;
- inicion ndryshime të akteve normative për zbatimin dhe avancimin e mbrojtjes nga diskriminimi;
- ofron opinione për propozim-ligje të rëndësishëm për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi;
- vendos bashkëpunim me personat fizikë dhe juridikë, si dhe me shoqata, fondacione, partnerë socialë për realizimin e parimit të barazisë dhe avancimin e parandalimit dhe mbrojtjes nga diskriminimi;
- bashkëpunon me autoritetet përkatëse kombëtare të shteteve të tjera, si dhe me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi;
- i trajton/procedon parashtrësat, nxjerr opinione, rekomandime dhe konkluzione për raste konkrete të diskriminimit;
- inicion procedurë për mbrojtje nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare;

- u ofron informacione personave të interesuar në lidhje me të drejtat dhe mundësitë e tij për iniciimin e procedurës gjyqësore ose të ndonjë procedure tjetër;
- e monitoron implementimin e opinionëve dhe rekomandimeve për raste konkrete të diskriminimit deri në përmbushjen e rekomandimeve të adresuara nga KPMD-ja;
- paraqitet si bashkëbisedues në procedurat gjyqësore;
- mund të veprojë si “mik i gjykatës” (amicus curiae);
- për punën e vet, KPMD-ja çdo tremujor raporton për rastet e diskriminimit, i ndan opinionet dhe rekomandimet e tij me publikun përmes medias;
- KPMD-ja ka mundësi të formojë organe këshillëdhënëse profesionale për çështje të caktuara specifike, të grumbullojë dhe publikojë të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera si dhe të krijojë baza të të dhënave lidhur me parandalimin dhe promovimin e mbrojtjes nga diskriminimi;
- KPMD-ja për punën e vet paraqet Raport vjetor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e ka për detyrë t'i publikojë të gjitha raportet, përfshirë edhe raportin financiar, në faqen e internetit të KPMD-së.

Anëtarët e KPMD-së

KPMD-ja përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa të njëjtit e gëzojnë statusin e personave të emëruar, të cilët funksionin e ushtrojnë në mënyrë profesionale, ndërkohë që ky funksion është i papajtueshëm me ushtrimin e ndonjë funksioni tjetër publik, profesioni ose funksioni në ndonjë parti politike. Anëtarët zgjidhen në procedurë transparente që e përfshin shpalljen publike të publikuar nga Kuvendi dhe zbatimin e detyrueshëm të diskutimit publik. Është jashtëzakonisht e rëndësishme të nënvizohet kriteri për zgjedhjen e anëtarit të KPMD-së të përcaktuar në ligj që kërkon një minimum prej shtatë vjetësh përvojë pune në fushën e të drejtave të njeriut, nga të cilat pesë vjet në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, me ç'rast garantohet profesionalizmi i anëtarëve të Komisionit dhe reduktohet mundësia e ndikimeve dhe arbitraritetit gjatë përzgjedhjes së anëtarëve.

Anëtarët e KPMD-së zgjidhen për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë për rizgjedhje të njëpasnjëshme. Gjatë zgjedhjes së përbërjes së parë të Komisionit, katër anëtarë zgjidhen për një mandat pesëvjeçar, ndërsa tre anëtarë për një mandat trevjeçar. Nga anëtarët e tij, Komisioni e zgjedh kryetarin për një mandat njëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Përbërja aktuale e Komisionit u zgjodh më datë 25.01.2021 dhe numëron vetëm pesë anëtarë, meqë edhe në vitin 2022 një anëtar dha dorëheqje për arsye personale, pas dorëheqjes së një anëtari në vitin 2021. Në kushte të prezencës dhe dukshmërisë gjithnjë e më të madh të KPMD-së në shoqërinë demokratike maqedonase dhe numrit konsiderueshëm më të madh të lëndëve të pranuar për mbrojtje nga diskriminimi në vitin 2022, gjendja e këtillë seriozisht e komplikon funksionimin normal, por nga ana tjetër krijon rreziqe për prolongimin e afateve të vendimmarrjes dhe reduktimin e efikasitetit në funksionimin e KPMD-së në përgjithësi.

Përbërja e KPMD-së e pasqyron karakterin shumetnik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, por nga pesë anëtarët vetëm një anëtar është grua, dhe për fat të keq nuk e përmbush kriterin e barazisë gjinore. Tre anëtarë të Komisionit kanë mandat pesëvjeçar ndërsa dy anëtarë kanë mandat trevjeçar.

Shërbimi profesional

Për kryerjen e punëve profesionale, administrative dhe teknike të Komisionit, formohet shërbimi profesional. Punonjësit në shërbimin profesional e kanë statusin e nëpunësit administrativë dhe për të njëjtit aplikohen dispozitat e Ligjit për nëpunësit administrativë. Shërbimin profesional e udhëheq Sekretari i Përgjithshëm i cili emërohet nga KPMD-ja.

Në bazë të analizës funksionale, u miratua dhe në zbatim e sipër është Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Rregullorja për Sistematizimin e Vendeve të Punës të Shërbimit Profesional, me të cilat u përcaktua struktura organizative si më poshtë:

1. Sektori për Mbështetje Administrative-Financiare

- 1.1. Seksioni për Çështje të Përgjithshme dhe Juridike
- 1.2. Seksioni për Marrëdhënie me Publikun
- 1.3. Seksioni për Çështje Financiare

2. Sektori për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi

- 2.1. Seksioni për Mbrojtje nga Diskriminimi
- 2.2. Seksioni për Parandalimin e Diskriminimit dhe Promovimin e Parimit të Barazisë

3. Sektori për Analitikë, Bashkëpunim Ndërinstitucional Kombëtar dhe për Bashkëpunim Ndërkombëtar

- 3.1. Seksioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Bashkëpunim me Institucionet dhe Organizatat Qytetare
- 3.2. Seksioni për Hulumtim dhe Analizë

Pasqyra grafike e strukturës organizative është prezantuar në Foto 1.




Foto 1

Rregullorja për Sistematizimin e Vendeve të Punës e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi përcakton 40 vende pune të nëpunësve administrativë me gjithsej 46 realizues, nga të cilat vetëm 16 vende pune janë të plotësuara, që nënkupton 34.8%. Numri i të punësuarve në krahasim me vitin 2021 është rritur për 6 nëpunës administrativë, të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune në KPMD përmes transferimit të përhershëm nga institucionet e tjera (4 punonjës) dhe përmes punësimit sipas procedurës me shpallje publike (3 punonjës). Në periudhën raportuese, një nëpunësi administrativ në pozicionin udhëheqës i pushoi marrëdhënia e punës në KPMD për shkak të transferimit të përhershëm në një institucion tjetër.

Përkrah përmirësimit të situatës me burimet njerëzore, plotësimi i vendeve të punës prej vetëm 34.8% e zvogëlon potencialin e Shërbimit Profesional për funksionimin pa pengesa, përmbushjen e detyrave të punës dhe realizimin dhe implementimin e kompetencave ligjore të Komisionit.

Përcaktimi strategjik për fuqizimin e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, si dhe krijimi i një shërbimi administrativ profesional dhe të pavarur të KPMD-së mbetet sfidë edhe për vitin 2023.

Statusi i implementimit të kompetencave të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi


Në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe Rregulloren e Punës, Komisioni është në punime të përhershme, ndërsa vendimet i merr në mbledhje të cilat konvokohen sipas nevojës. Në vitin 2022 u mbajtën 25 mbledhje në të cilat u miratuan 214 vendime për lëndë konkrete.

Parashtresa dhe procedura për mbrojtjen nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare

Në vitin 2022, pranë Komisionit u paraqitën 248 parashtresa për mbrojtjen nga diskriminimi, prej të cilave 157 nga persona fizikë dhe 91 nga persona juridikë. Krahasuar me vitin paraprak 2021, kur u pranuan 86 parashtresa nga persona fizikë dhe juridikë, numri është rritur madje për 162 parashtresa, që është një rritje prej 188.37%.

U iniciuan edhe 7 procedura për mbrojtjen nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare. Krahasuar me vitin paraprak 2021, kur u iniciuan 4 procedura, numri është rritur për 75%.

Në mënyrë kumulative, kur do t'i marrim parasysh të gjitha lëndët për mbrojtje nga diskriminimi, përkatësisht parashtresat e pranuar dhe parashtresat e iniciuara sipas detyrës zyrtare, në vitin 2022 kemi regjistruar 255 lëndë, që krahasuar me 90 lëndët në vitin 2021 paraqet një rritje prej 165 lëndë, ose rritje prej 183.33%. (Grafiku 1.)




Grafiku 1

Në Grafikon 2 është prezantuar krahasimi i numrit të lëndëve për mbrojtje nga diskriminimi sipas tremujorëve në vitin 2021 dhe në vitin 2022. Në vitin 2022, ka një rritje të konsiderueshme në tremujorët e krahasuar me vitin 2021, një vazhdimësi e rritjes e cila filloi në vitin 2021 dhe një konsolidim të numrit të parashtresave të pranuar me një mesatare prej 63.75 lëndë/në nivel tremujor.

Parashtresë për diskriminim mund t'i paraqitet Komisionit në disa mënyra – me postë, personalisht në ambientet e KPMD-së dhe në mënyrë elektronike.

- Paraqitja e parashtresës me postë bëhet përmes dërgesës së modelit të plotësuar për denoncimin e diskriminimit në adresën e Komisionit.
- Parashtresa mund të paraqitet personalisht me gojë (verbalisht) ose përmes plotësimit të modelit për denoncimin e diskriminimit.
- Paraqitja elektronike e parashtresave është e mundur përmes shërbimit të instaluar elektronik “Denonco Diskriminimin” që gjendet në faqen e internetit të Komisionit (<https://kszd.mk/пријави-дискриминација/Denonco-Diskriminimin/>) ose përmes dërgesës në e-postën në contact@kszd.mk.


Parashtresa duhet t’i përmbajë elementët e rëndësishëm si vijon – të dhëna për parashtruesin, të dhëna për personin kundër të cilit është paraqitur parashtresa, rrethanat dhe faktet mbi të cilat bazohet parashtresa, të dhëna për veprimet juridike të ndërmarra paraprakisht nga parashtruesi, nëse i posedon dhe nënshkrimi i parashtruesit.



Grafiku 2


Të dhëna demografike për parashtruesit e parashtresave

Nga gjithsej 157 persona fizikë që kanë parashtruar parashtresa për mbrojtjen nga diskriminimi në vitin 2022, 15 nuk janë deklaruar për përkatësinë e tyre sipas seksit. Nga ata që janë deklaruar, 60 janë gra ndërsa 82 burra. Në Grafikon 3 është pasqyruar ky proporcion i shprehur në përqindje.




Grafiku 3

Për sa i përket përkatësisë kombëtare, 68 parashtrues nuk u deklaruan. Nga ata që u deklaruan, më së shumti parashtrësja janë paraqitur nga qytetarët e përkatësisë etnike maqedonase (48), pastaj vijojnë qytetarët të përkatësisë etnike shqiptare (14), pastaj qytetarët të përkatësisë etnike bullgare (8), qytetarët të përkatësisë etnike serbe (4), qytetarët të përkatësisë etnike turke (3), etj. Pasqyra e plotë e numrit të parashtrësive të parashtruesve sipas përkatësisë së tyre kombëtare është prezantuar në Grafikon 4.



Grafiku 4

Në Grafikon 5 është prezantuar pasqyra e parashtruesve të parashtrësive sipas moshës së tyre. Numri më i madh i parashtrësive u paraqitën nga qytetarët e moshës 41-50 vjeç, pastaj nga qytetarët e moshës 31-40 vjeç dhe qytetarët e moshës 51-60 vjeç. Të dhënat e moshës nuk i kanë paraqitur 50 parashtrues të parashtrësive.



Grafiku 5

Numri më i madh i parashtrësive për mbrojtje nga diskriminimi në vitin 2022 janë parashtruar nga qytetarët dhe organizatat me seli në Shkup (151 parashtrësja, ose 61%). Pastaj vijojnë Manastiri (18 parashtrësja), Shtipi (14 parashtrësja), Velesi (7 parashtrësja) dhe Kumanova (5 parashtrësja). Pasqyra e përgjithshme është prezantuar në Tabelën 1.


Vendi / Selia e parashtruesve të parashtrësive	_Numri i parashtrësive
Shkup	151
Manastir	18
Shtip	14
Veles	7
Kumanovë	5
Gjevgjeli	4
Kavadar	4
Radovish	4
Gostivar	3
Kërçovë	3
Prilep	3
Tetovë	3
Dellçevë	2
Demir Hisar	2
Ilinden	2
Koçani	2
Negotinë	2
Strugë	2
Berovë	1
Demir Kapi	1
Kriva Pallankë	1
Krivogashtan	1
Likovë	1
Makedonska Kamenicë	1
Novaci	1
Strumicë	1
Tearcë	1
Qendra Zhupë	1
Çuçer Sandevë	1

_Tabela

Në vitin 2022, Komisionit me 4 parashtrësia për mbrojtje nga diskriminimi iu drejtua edhe një organizatë me seli në Bruksel, Belgjikë. Mes tjerash janë pranuar edhe dy parashtrësia anonime për të cilat nuk dihet vendbanimi i parashtruesit.

Fushat e denoncuara të diskriminimit

Numri më i madh i lëndëve për mbrojtje nga diskriminimi në vitin 2022 ishin në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës (86 , lëndë) dhe në fushën e informimit publik dhe medias (78 lëndë). Pastaj vijnë fushat qasja në të mira dhe shërbime (26 lëndë), arsimi, shkenca dhe sporti (21 lëndë), siguria sociale, duke e përfshirë edhe sferën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe sferën e mbrojtjes shëndetësore (18 lëndë), etj. Pasqyra e përgjithshme e numrit të lëndëve në secilën nga fushat është prezantuar në Grafikon 6¹.




Grafiku 6

Lidhur me parashtresat e paraqitura nga personat fizikë, numri më i madh i tyre ka të bëjë me denoncime për mbrojtje nga diskriminimi në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës (Grafiku 7). Kjo fushë u denoncua madje në 84 parashtresa, që nënkupton më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të parashtresave, përkatësisht 53.50%. Fushat e tjera të denoncuara kanë të bëjnë me qasjen në të mira dhe


¹ Grafiku 6 e pasqyron se në sa lëndë është denoncuar fusha konkrete e diskriminimit. Duke e pasur parasysh se në 14 lëndë, parashtresit kanë denoncuar diskriminim në më shumë se një fushë, numri i lëndëve në secilën prej fushave të prezantuara në Grafikon 6 është më i madh se numri i përgjithshëm i lëndëve për mbrojtje nga diskriminimi. Ky shënim vlen edhe për të gjitha pasqyrat e tjera statistikore në këtë Raport që e pasqyrojnë numrin e lëndëve në fusha konkrete.

shërbime (18 parashtresa, ose 11,46%), sigurinë sociale, duke e përfshirë sferën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen shëndetësore (15 parashtresa ose 9,55%) arsimin, shkencën dhe sportin (13 parashtresa ose 8,28%), etj. Pasqyra e përgjithshme e numrit të parashtresave të parashtruara nga personat fizikë në secilën prej fushave është prezantuar në Grafikon 7.




Grafiku 7

Analiza e të dhënave tregon se **gratë** kryesisht kanë denoncuar diskriminim në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës (36 parashtresa), pastaj vijojnë fushat e sigurimeve sociale, përfshirë këtu edhe sferën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe kujdesin shëndetësor (7 parashtresa) dhe fushën e qasjes në të mira dhe shërbime (6 parashtresa), etj. Edhe burrat më së shpeshti kanë denoncuar diskriminim në fushën e marrëdhënieve të punës (42 parashtresa), pastaj qasja në të mira dhe shërbime (11 parashtresa) dhe fushën e arsimit, shkencës dhe sportit, (7 parashtresa) sigurimit social, duke e përfshirë edhe sferën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen shëndetësore (7) etj. Përqindja e përfaqësimit, përkatësisht pjesa e secilës prej fushave të denoncuar të diskriminimit në kuadër të parashtresave të parashtruara nga gratë, përkatësisht burrat është prezantuar në Grafikon 8.



Grafiku 8

Ndryshe nga personat fizikë, **personat juridikë më së shpeshti i janë drejtuar Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi në fushën e informimit publik dhe medias.** Kjo fushë u denoncua madje në 84 parashtresa, që paraqet 74,73% nga numri i përgjithshëm i parashtresave. Nga fushat e tjera të denoncuar, e veçojmë qasjen në të mira dhe shërbime (7 parashtresa, ose 7.69%) dhe arsimin, shkencën dhe sportin (5 parashtresa, ose 5.49%). Pasqyra e përgjithshme e numrit të parashtresave të parashtruara nga persona juridikë në secilën prej fushave është prezantuar në Grafikon 7.




Grafiku 9

Nga procedurat e iniciuara sipas detyrës zyrtare, 2 kanë të bëjnë me fushën e arsimit, shkencës dhe sportit, 2 me fushën e informimit publik dhe medias, pastaj 1 procedurë me fushën e qasjes në të mira dhe shërbime, 1 procedurë me mbrojtjen nga diskriminimi në një fushë tjetër, përkatësisht në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe 1 procedurë e cila ka të bëjë me dy fusha, përkatësisht me fushën e arsimit, shkencës dhe sportit dhe fushën e jurisprudencës dhe institucioneve të pushtetit qendror.

Bazat e denoncuara të diskriminimit

Nga gjithsej 255 lëndë për mbrojtje nga diskriminimi, në 111 lëndë është denoncuar një bazë e diskriminimit, ndërsa në 114 lëndë është denoncuar diskriminim mbi dy ose më shumë baza (Grafiku 10).



Grafiku 10


Nga parashtruesat për diskriminim mbi më shumë baza janë regjistruara:

- 35 për diskriminim mbi dy baza
- 17 për diskriminim mbi tre baza
- 10 për diskriminim mbi katër baza
- 5 për diskriminim mbi pesë baza
- 44 për diskriminim mbi gjashtë baza
- 2 për diskriminim mbi shtatë baza, dhe
- 1 parashtruesë për diskriminim mbi tetë baza.

Deri te Komisioni gjatë periudhës raportuese, u parashtruan 30 parashtrues në të cilat parashtruesit në mënyrë konkrete nuk kanë specifikuar asnjë bazë diskriminimi.


Baza më shpesh e denoncuar për diskriminim në vitin 2022 ishte përkatësia kombëtare ose etnike (në 124 lëndë, ose 48.63%). Pastaj vijnë baza e cilësisë personale dhe statusit shoqëror (në 75 lëndë, ose 29.41%), seksi (në 56 lëndë, ose 21.96%), përkatësia në një grup të marginalizuar (51 lëndë, ose 20.00%), identiteti gjinor (45 lëndë, ose 17.65%), dhe orientimi seksual (në 43 lëndë, ose 16.86%). Pasqyra e plotë e bazave të denoncuara për diskriminim në lëndët e vitit 2022 është prezantuar në Grafikon 11².

² Grafiku 11 e pasqyron se në sa lëndë është denoncuar baza konkrete e diskriminimit. Duke e pasur parasysh se në 114 lëndë është denoncuar diskriminim mbi më shumë baza, numri i lëndëve për secilën nga bazat e diskriminimit të prezantuara në Grafikon 11 do të jetë gjithmonë më i madh se numri i përgjithshëm i lëndëve për mbrojtje nga diskriminimi. Ky shënim vlen edhe për të gjitha pasqyrat e tjera statistikore në këtë Raport të cilat e prezantojnë numrin e rasteve sipas bazave të diskriminimit.




Grafiku 11

Lidhur me parashtrësit e parashtruar nga personat fizikë, pjesa më e madhe ka të bëjë me denoncimin për mbrojtje nga diskriminimi mbi bazën e përkatësisë kombëtare ose etnike. Kjo bazë u denoncua në 44 parashtrësia, që nënkupton 28.03%. Pastaj vijojnë denoncime për diskriminim mbi bazën e cilësisë personale dhe statusit shoqëror (27 parashtrësia, ose 17.20%), mbi ndonjë bazë tjetër (26 parashtrësia, ose 16.56%), bindja politike (24 parashtrësia, ose 15.29%), etj. Pasqyra e plotë e numrit të parashtrësive të parashtruar nga personat fizikë sipas bazave të denoncuar është prezantuar në Grafikon 12.




Grafiku 12

Analiza e të dhënave tregon se **edhe tek burrat edhe tek gratë, baza më shpesh e denoncuar për diskriminim ishte përkatësia kombëtare ose etnike**, tek gratë në 17 parashtrësia ndërsa tek burrat në 25 parashtrësia. Sa i përket bazave të tjera të diskriminimit, më të pranishme tek gratë ishin cilësia personale dhe statusi shoqëror (14 parashtrësia), bindja politike (11 parashtrësia), seksi (8 parashtrësia) dhe baza të tjera (8 parashtrësia), ndërsa tek burrat, mbi ndonjë bazë tjetër (17 parashtrësia), cilësia personale dhe statusi shoqëror (13 parashtrësia), bindja politike (11 parashtrësia) dhe origjina sociale (10 parashtrësia). Pasqyra e plotë e bazave të denoncuar për diskriminim tek gratë dhe burrat prezantohet në Grafikët 13 dhe 14.




Grafiku 13



Grafiku 14

Ashtu si edhe tek personat fizikë, përkatësia kombëtare ose etnike është baza më shpesh e denoncuar për diskriminim edhe në parashtrësit e parashtruara nga personat juridikë. Me fjalë të tjera, nga gjithsej 91 parashtrës, kjo bazë u denoncua madje në 78 parashtrës, që paraqet 85.71%. Pastaj vijojnë bazat e cilësisë personale dhe statusi shoqëror (47 parashtrës, ose 51.65%) dhe përkatësia në një grup të marginalizuar (gjithashtu 47 parashtrës, ose 51.65%). Bazat më shpesh të denoncuar e përfshijnë seksin (44 parashtrës, ose 48.35%), identitetin gjinor (42 parashtrës, ose 46.15%) dhe orientimin seksual (42 parashtrës, ose 46.15%). Pasqyra e plotë e numrit të parashtrësve të parashtrësit nga personat juridikë sipas bazave të diskriminimit është prezantuar në Grafikon 15.



Grafiku 15


Nga procedurat e iniciuara sipas detyrës zyrtare, 3 kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar, 2 për shkak të përkatësisë kombëtare ose etnike, 1 për shkak të gjendjes shëndetësore dhe 1 për mbrojtje nga diskriminimi mbi dy baza - seksi dhe cilësia personale dhe statusi shoqëror.

Vendimmarrja e Komisionit lidhur me parashtresat dhe procedurat e iniciuara për mbrojtje nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare

Duke vepruar mbi parashtresat e parashtruara dhe procedurat e iniciuara për mbrojtjen nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare, Komisioni në vitin 2022 miratoi **gjithsej 214 vendime** si më poshtë:

- 134 opinione, nga të cilat
 - 70 opinione me të cilat u konstatua diskriminim
 - 64 opinione me të cilat u konstatua diskriminim
- 17 konkluzione për mosinicimin, mosveprimin ose pezullimin e procedurës, nga të cilat
 - 10 konkluzione për mosinicimin ose pezullimin e procedurës nëse parashtruesi vendos ta revokojë parashtresën gjatë procedimit
 - 5 konkluzione për mosveprimin ose pezullimin e procedurës ndaj parashtresës për shkak të procedurës gjyqësore në vijim e sipër për diskriminim
 - 2 konkluzione për mosinicimin e procedurës lidhur me parashtresën për të cilën Komisioni tani më ka vepruar, ndërsa nuk janë prezantuar fakte dhe rrethana të reja
- 63 vendime për hedhjen poshtë të parashtresës së paraqitur, nga të cilat
 - 16 vendime për hedhjen poshtë të parashtresës për shkak të jokompetencës
 - 44 vendime për hedhjen poshtë të parashtresës për shkak të parregullsisë
 - 3 vendime për hedhjen poshtë të parashtresës për shkak të parashkrimit

Krahasuar me vitin paraprak 2021, kur u miratuan gjithsej 131 vendime, në vitin 2022 numri u rrit për 83, që është një rritje prej 63.36%. Grafiku 16 ofron një pasqyrë komparative të numrit të vendimeve të miratuara në vitin 2021 dhe 2022, për secilin lloj të vendimit veç e veç.




Grafiku 16

Nga gjithsej 214 vendime të miratuara në vitin 2022, 183 kanë të bëjnë me denoncimet për mbrojtje nga diskriminimi të filluara në vitin 2022, ndërsa 31 vendimet e tjera janë vendime për denoncime, procedura e të cilave filloi në vitin 2021 ndërsa vazhdoi dhe përfundoi në vitin 2022.

Përfundimisht me datë 31.12.2022, për 77 parashtrës, procedimi, përkatësisht vendimmarrja është akoma në rrjedhë e sipër.

Diskriminim i konstatuar në vitin 2022

Në vitin 2022, Komisioni konstatoi 70 raste të diskriminimit sipas parashtrësve të parashtruara dhe procedurave të iniciuara sipas detyrës zyrtare. Duke analizuar të dhënat e opinioneve me diskriminim të konstatuar, erdhëm në përfundimin se **lloji më i shpeshtë i diskriminimit në vitin 2022 ishte ngacmimi (i pranishëm në 39 raste)**, pastaj vijon diskriminimi direkt (në 25 raste) dhe thirrja, nxitja dhe instruksioni për diskriminim (në 17 raste). Pasqyra e plotë e llojeve të diskriminimeve të konstatuara është prezantuar në Grafikon 17.



Grafiku 17

Megjithëse në shumicën e rasteve Komisioni konstatoi diskriminim në një formë konkrete (54 raste), e shpeshtë është edhe gjetja në rastet kur lloje të ndryshme të diskriminimit janë të pranishme njëkohësisht ose krijohen si pasojë (16 raste). Për shembull, në 11 raste, Komisioni konstatoi ngacmim, si dhe thirrje, nxitje dhe instruksion për diskriminim. U konstatuan tre raste të diskriminimit, të cilët shkaktojnë segregacion, nga të cilat dy raste janë diskriminim indirekt ndaj një grupi më të madh qytetarësh, ndërsa në një rast bëhet fjalë për diskriminim direkt ndaj një personi me të cilin shkaktohet segregacion dhe përjashtim. Nga ana tjetër, u konstatua një rast i diskriminimit direkt dhe ngacmim, me ç'rast u konstatua edhe ekzistenca e viktimizimit ndaj personit që ndërmoi veprime për mbrojtje nga diskriminimi, etj.


Nga 70 rastet e denoncuara për diskriminim në vitin 2022, **23 raste paraqesin forma më të rënda të diskriminimit**, si më poshtë:

- 11 raste të formave më të rënda të diskriminimit direkt:
 - o 8 raste të diskriminimit të zgjatur direkt

- 1 rast i diskriminimit të zgjatur direkt ndërsektorial
- 1 rast i diskriminimit të përsëritur dhe të zgjatur direkt
- 1 rast i diskriminimit të shumëfishtë dhe të zgjatur direkt
- 10 raste të formave më të rënda të ngacmimit
 - 2 raste të ngacmimit të zgjatur
 - 1 rast i ngacmimit të shumëfishtë
 - 4 raste të ngacmimit të zgjatur dhe të shumëfishtë
 - 2 raste të ngacmimit të zgjatur dhe të përsëritur
 - 1 rast i ngacmimit të zgjatur të përsëritur dhe të shumëfishtë
- 1 rast i formës më të rëndë të thirrjes, nxitjes dhe instruksionit për diskriminim
 - Rasti i thirrjes, nxitjes dhe instruksionit të zgjatur për diskriminim
- 1 rast i formës më të rëndë të diskriminimit që përcaktohet në dy lloje
 - Rasti i ngacmimit të zgjatur dhe të shumëfishtë dhe rasti i thirrjes, nxitjes dhe instruksionit të zgjatur dhe të shumëfishtë për ngacmim


Bazat e diskriminimit në rastet e konstatuara në vitin 2022

Në vitin 2022, baza më e shpeshtë e diskriminimit ishte orientimi seksual, i cili u konstatua në 25 nga gjithsej 70 raste. Pastaj vijojnë bazat e përkatësisë në një grup të marginalizuar (22 raste), identiteti gjinor (20 raste), cilësia personale dhe statusi shoqëror (20 raste), përkatësia kombëtare ose etnike (19 raste) dhe seksi (17 raste). U konstatuar diskriminim edhe mbi 15 baza të tjera të diskriminimit, ndërsa pasqyra e përgjithshme është prezentuar në Grafikon 18.



Grafiku 18


Në rastet në fjalë, shumë shpesh është konstatuar se diskriminimi është ushtruar mbi disa baza të diskriminimit. Në të vërtetë, në 61% të rasteve (43 nga 70), Komisioni konstatoi se i njëjti është ushtruar mbi dy ose më shumë baza të diskriminimit: 23 raste diskriminimi mbi dy baza, 3 raste diskriminimi mbi tre baza, 4 raste diskriminimi mbi katër baza dhe 13 raste diskriminimi mbi pesë baza (Grafiku 19). Bazat më të pranishme të diskriminimit nga Grafiku 17 shpesh paraqiten njëkohësisht në raste konkrete. Për më tepër, Komisioni konstatoi diskriminim madje në 9 raste me ç'rast i njëjti është kryer mbi 5 baza të diskriminimit në vijim: seksi, përkatësia në një grup të marginalizuar, orientimi seksual, identiteti gjinor dhe cilësia personale dhe statusi shoqëror.



Grafiku 19

Fushat e diskriminimit në rastet e konstatuara në vitin 2022

Në vitin 2022, fusha më e shpeshtë e diskriminimit ishte fusha e informimit publik dhe medias, e cila u konstatua në 37 raste, përkatësisht në 52.86%. Pastaj vijojnë fushat e punës dhe marrëdhënieve të punës të konstatuara në 15 raste, qasja në të mira dhe shërbime në 10 raste dhe arsimit, shkencën dhe sportin në 7 raste. Pasqyra e plotë është prezantuar në Grafikon 20. Në dy raste, Komisioni konstatoi diskriminim që ishte kryer në dy fusha të ndryshme: në rastin e parë - diskriminim në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës dhe diskriminim në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit, ndërsa në rastin e dytë - diskriminim në fushën e veprimit të anëtarësimit dhe veprimit në partitë politike, shoqata, fondacione, organizata sindikaliste ose organizata të tjera në bazë të anëtarësimit dhe në fushën e informimit publik dhe medias.



Grafiku 20

Më vazhdim është pasqyra e specifikave të rasteve të diskriminimit të konstatuara në vitin 2022 për secilën nga fushat.

Diskriminimi në fushën e informimit publik dhe medias

Diskriminimi në fushën e informimit publik dhe medias u konstatua në 37 raste. Në një nga rastet, diskriminim u konstatua në dy fusha, në fushën e informimit publik dhe medias dhe në fushën e anëtarësimit dhe aktivitetit në parti politike, shoqata, fondacione, organizata sindikaliste ose organizata të tjera të bazuara në anëtarësimin ndërkaq do të shqyrtohet veçmas.


Nga 36 rastet që do të shqyrtohen në këtë drejtim, u konstatua se diskriminimi në fushën e informimit publik dhe medias është më së shumti i përhapur në rrjetet sociale (gjithsej 33 raste) dhe shfaqet në formën e ngacmimit dhe/ose thirrjes, nxitjes dhe instruksionit, i cili shpesh është i pranishëm në forma më të rënda siç është diskriminimi i zgjatur, i përsëritur dhe i shumëfishtë. Viktima më të shpeshta në rrjetet sociale ishin pjesëtarët e komunitetit LGBTI me 26 raste të konstatuara. Në tre raste, Komisioni konstatoi edhe diskriminim në rrjetet sociale ndaj qytetarëve që i përkasin komunitetit bullgar, pastaj një rast diskriminimi ndaj pjesëtarëve të komunitetit shqiptar dhe ndaj maqedonasve të besimit mysliman, një rast diskriminimi ndaj pjesëtarëve të komunitetit rom dhe një rast diskriminimi ndaj qytetarëve që janë oponentë politik me diskriminuesin dhe pjesëtarëve të komunitetit turk. Në një nga rastet e diskriminimit

në rrjetet sociale u konstatua edhe **ngacmimi seksual** i kryera nga një drejtues emisioni ndaj një gruaje në bazë të seksit dhe gjinisë.

Përveç në rrjetet sociale, Komisioni konstatoi edhe **2 raste diskriminimi të ushtruara në televizionet kombëtare**, përkatësisht gjatë emisioneve debative, të cilat transmetohen në televizionet kombëtare nga ana e pjesëmarrësve në të njëjtat. Mes tjerash u konstatua edhe **1 rast diskriminimi i kryer në portalin e internetit** përmes publikimit të përmbajtjeve, të cilat shkaktonin ngacmime të shumëfishta dhe të zgjatura dhe ngacmim seksual.

Bazat e diskriminimit në rastet e fushës së informimit publik dhe medias

Rastet e diskriminimit në fushën e informimit publik dhe medias më së shpeshti janë të pranishme si diskriminim mbi më shumë baza. Gjegjësisht, nga 36 raste, madje në 28 raste u konstatua diskriminim mbi dy ose më shumë baza diskriminimi, që është 77.78% e rasteve. Sa për ilustrim, Komisioni konstatoi diskriminim në fushën e medias të kryer mbi dy baza në 14 raste dhe diskriminim mbi pesë baza në 10 raste. **Baza më e përhapur e diskriminimit në fushën e informimit publik dhe medias është orientimi seksual (25 raste)**, ndërsa pastaj pason identiteti gjinor (20 raste), përkatësia në një grup të marginalizuar (16 raste) dhe seksi (14 raste). Prania e secilës prej bazave të diskriminimit në rastet e fushës së informimit publik dhe medias të konstatuara në vitin 2022 pasqyrohen në Grafikon 21.



Grafiku 21

Diskriminimi në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës


Diskriminim në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës u konstatua në 15 raste. Në një nga rastet, diskriminim u konstatua në dy fusha, në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës dhe në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit dhe i njëjti do të shqyrtohet veçmas.

14 rastet që do të analizohen këtu, paraqesin diskriminim të ushtruar nga punëdhënësi, përkatësisht nga epror i drejtpërdrejtë ndaj të punësuarve. **Të gjitha rastet e diskriminimit në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës kanë ndodhur në institucionet e sektorit publik**, nga të cilat 6 në institucionet shtetërore, 4 nëpër komuna, 1 në një institucion shëndetësor, 1 në një shkollë fillore ndërsa në 1 rast u konstatua diskriminim i kryer nga një komunë dhe një shkollë fillore.

Në lidhje me **llojet e diskriminimit**, në 8 raste u konstatua diskriminim direkt ndaj një personi të punësuar (nga të cilat në 1 rast si diskriminim i zgjatur), në 5 raste u konstatua ngacmim në vendin e punës (nga të cilat në 1 rast si ngacmim i zgjatur). Në rastin e fundit, u konstatua diskriminim i zgjatur direkt ndaj personit të punësuar dhe ngacmim në vendin e punës, si dhe viktimizim si formë e diskriminimit që nënkupton vuajtjen e pasojave të dëmshme të personit që ka ndërmarrë veprime për mbrojtje nga diskriminimi.

Bazat e diskriminimit në rastet e fushës së punës dhe marrëdhënieve të punës

Baza më shpesh e konstatuar e diskriminimit në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës është cilësia personale dhe statusi shoqëror (7 raste), kurse pason bindja politike (4 raste). Në Grafikon 22 është pasqyruar prezenca e secilës prej bazave në rastet e diskriminimit në këtë fushë.



Grafiku 22

Diskriminimi në fushën e qasjes në të mira dhe shërbime


Diskriminim në fushën e qasjes në të mira dhe shërbime u konstatua në 10 raste. Në 8 raste, bëhet fjalë për diskriminim të ushtruar nga institucionet e sektorit publik, përkatësisht 3 raste nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, 4 nga një komunë dhe 1 rast nga një ndërmarrje publike e themeluar nga të njëjtat dhe 1 nga një ndërmarrje e transportit publik. Në 2 rastet e tjera u konstatua diskriminim i ushtruar nga personat juridikë dhe privatë.

Lidhur me **llojet e diskriminimit**, në të gjitha rastet bëhet fjalë për diskriminim direkt, nga të cilat në 4 raste u konstatua se i njëjti është i zgjatur, ndërsa në 1 rast si diskriminim i zgjatur dhe i shumëfishtë.

Diskriminimi në qasjen në të mira dhe shërbime në 9 raste u konstatua se bëhet fjalë për qasje të pamundësuar ose të kufizuar në të mira dhe shërbime të kryer ndaj një grupi më të madh qytetarësh. Përkatësisht, në 4 raste u konstatua diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara, në 4 raste të tjera Komisioni konstatoi diskriminim ndaj pjesëtarëve të komunitetit etnik rom dhe në 1 rast diskriminim ndaj pjesëtarëve të komunitetit etnik turk. Së fundi, në një rast, u konstatua diskriminim sa i përket qasjes në shërbime i kryer nga personi juridik privat ndaj qytetarit në bazë të origjinës së tij sociale dhe cilësisë personale dhe statusit shoqëror.

Bazat e diskriminimit në rastet e fushës së qasjes në të mira dhe shërbime

Rastet e diskriminimit në fushën e qasjes në të mira dhe shërbime më së shpeshti janë të pranishme si diskriminim mbi më shumë baza. Me fjalë të tjera, në 4 raste u konstatua diskriminim mbi dy baza, në 2 raste u konstatua diskriminim mbi katër baza dhe në 2 raste diskriminim mbi pesë baza. Vetëm në 2 raste, Komisioni konstatoi se diskriminimi sa i përket qasjes në të mira dhe shërbime është kryer mbi një bazë diskriminimi. **Bazat më shpesh të konstatuara të diskriminimit në fushën e qasjes në të mira dhe shërbime janë përkatësia kombëtare ose etnike dhe përkatësia në një grup të marginalizuar**, ndërsa pastaj vijon origjina sociale. Në Grafikon 22 është pasqyruar prezenca e secilës prej bazave në rastet e diskriminimit në këtë fushë.



Diskriminimi në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit

Diskriminim në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit u konstatua në 7 raste. Siç e theksuam paraprakisht, në një nga rastet, diskriminim u konstatua në dy fusha, në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës dhe në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit dhe i njëjti do të shqyrtohet veçmas.

Nga 6 rastet që do të analizohen, 5 janë raste të diskriminimit në fushën e arsimit dhe 1 rast i diskriminimit në fushën e sportit.

Në fushën e arsimit, Komisioni konstatoi diskriminim në rastet si vijon:


- 2 raste të diskriminimit indirekt që shkakton segregacion, i cili rezulton nga dispozitat e Ligjit për arsimin fillor ndaj nxënësve të përkatësisë të komunitetit etnik rom (rasti i parë në një shkollë fillore në Manastir dhe rasti i dytë në një shkollë fillore në Shtip), i cili ka ndodhur gjatë regjistrimit të nxënësve romë në vitin shkollor, në atë mënyrë që ata sistematizohen në "paralele të pastra etnike". Ai rezulton nga neni 63 i Ligjit për arsimin fillor dhe është një problem sistemor që shkakton segregacion në shkollat në të gjithë vendin. I inkurajuar nga këto dy raste, Komisioni, në prill të vitit 2022 miratoi një Rekomandim të Përgjithshëm për eliminimin e segregacionit në arsimin fillor me fokus të veçantë mbi nxënësit romë.
- 1 rast segregacioni dhe përjashtimi i nxënësve në bazë të aftësisë së kufizuar në një shkollë fillore, i kryer me ndarje fizike të pajustificuar dhe të paligjshme nga nxënësit e tjerë në një hapësirë të veçantë, në izolim nga nxënësit pa aftësi të kufizuara, dhe diskriminim i zgjatur direkt i kryer nga shkolla fillore me mospërshtatjen e infrastrukturës shkollore, në kuptimin e sigurimit të një hapësire me burime-shqisore, të pajisur me teknologji të përshtatshme asistive, që rezultoi me pamundësimin e qasjes në arsim në mënyrë të barabartë me të tjerët në bazë të aftësisë së kufizuar dhe nevojave të veçanta arsimore.
- 1 rast diskriminimi direkt i kryer nga një shkollë e mesme në Manastir ndaj një nxënësi pjesëtar i komunitetit etnik rom, të cilit i është shqiptuar masa pedagogjike – largim nga shkolla, pa i dhënë mundësinë të ndjekë mësimin, siç u veprua me nxënësit e tjerë të cilëve iu shqiptua masa e njëjtë pedagogjike.
- 1 rast ngacmim mbi bazë të përkatësisë etnike dhe religjionit ose besimit fetar të kryer nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për mos heqjen e përmbajtjeve në tekstet shkollore të historisë për arsimin e mesëm që shkaktojnë ndjenjë poshtërimi, stigmatizimi dhe shkelje të dinjitetit të boshnjakëve.

Në fushën e sportit, duke vepruar në bazë të parashtrës së parashtruar nga klubet e karatesë-anëtarë të Federatës së Karatesë së Maqedonisë, Komisioni konstatoi **diskriminim të përsëritur dhe të zgjatur direkt në bazë të cilësisë personale dhe statusit shoqëror, si dhe në bazë të moshës**, të kryer nga Federata e Karatesë së Maqedonisë ndaj një grupi sportistësh- të karatesë, anëtarë të disa klubeve të karatesë-anëtarë të FKM-së dhe diskriminim të tërthortë nga BE i FKM-së me miratimin e Rregullores për Zgjedhjen, Financimin dhe dhënien e Çmimeve të seleksioneve të kombëtareve shtetërore dhe Vendimi për

përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për përzgjedhjen e garuesve që do të marri pjesë në Kampionatin Evropian në Pragë të Çekisë në kategorinë kadetë, juniorë dhe seniorë U21 më datë 29.10.2021, nënshkruar nga u.d. Drejtori.

Bazat e diskriminimit në rastet e fushës së arsimit, shkencës dhe sportit

Baza më e shpeshtë për diskriminim në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit është përkatësia kombëtare ose etnike. Në Grafikon 24 është pasqyruar prezenca e secilës prej bazave në rastet e diskriminimit në këtë fushë.



Grafiku 24

Diskriminim në fushën e sigurimit social, duke përfshirë edhe sferën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen shëndetësore

Diskriminim në fushën e sigurimit social, duke e përfshirë sferën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen shëndetësore, u konstatua në 2 raste, nga të cilat një rast në fushën e mbrojtjes shëndetësore, ndërsa rasti i dytë në fushën e sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore.

Në rastin e parë, Komisioni konstatoi **diskriminim të zgjatur direkt në bazë të seksit** në fushën e mbrojtjes shëndetësore, të kryer nga Institucioni i Shëndetit Publik Klinika Universitare për Sëmundjet Pediatrike ndaj baballarëve të fëmijëve që janë të shtruar në spital, në mënyrë të tillë që spitali ka inkorporuar praktika që i pamundësonin baballarët të shoqëronin fëmijët e tyre të hospitalizuar në kushte të barabarta me nënat e fëmijëve të hospitalizuar.

KPMD-ja i rekomandoi ISHP KU për Sëmundje Pediatrike në afat prej 90 ditëve ta shmangë praktikën diskriminuese dhe të gjejë një mënyrë për t'u mundësuar baballarëve t'i shoqërojnë fëmijët e tyre të shtruar në spital në kushte të barabarta dhe ta gëzojnë të njëjtin trajtim si nënat e fëmijëve të shtruar në

spital, si dhe në të ardhmen të përmbahen nga ndërmarrja e veprimeve diskriminuese në bazë të seksit ose ndonjë baze tjetër në përputhje me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Në rastin e dytë, Komisioni konstatoi diskriminim të zgjatur direkt ndërsektorial në bazë të seksit, racës, përkatësisë në një grup të marginalizuar, përkatësisë etnike dhe origjinës sociale të kryera nga Ministria e Shëndetësisë ndaj grave rome që jetojnë në territorin e Komunës së Shuto Orizarit, në fushën e sigurimit shëndetësor dhe mbrojtjes shëndetësore, duke rezultuar me një qasje të pabarabartë sa i përket mbrojtjes shëndetësore në krahasim me gratë jo rome që jetojnë në komunat e tjera në territorin e Qytetit të Shkupit. Komisioni i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë të sigurojë të drejtën e barazisë së qasjes në mbrojtjen shëndetësore dhe shërbime shëndetësore për gratë rome që jetojnë në Komunën e Shuto Orizarit duke propozuar një Program që do të përfshijë masa afirmative, aktivitete dhe stimuj shtesë financiarë për institucionet shëndetësore private që ofrojnë mbrojtje shëndetësore gjinekologjike-obstetrike në mënyrë që të stimulojnë interes më të lartë për të kryer vazhdimisht aktivitetin e tyre në Poliklinikën në Komunën e Shuto Orizarit, dhe të njëjtin Program t'ia dërgojnë për miratim Qeverisë brenda 90 ditëve.

Raste të diskriminimit u konstatuan në dy fusha

Siç u përmend më herët, Komisioni konstatoi 2 raste në të cilat u konstatua diskriminim në dy fusha që shqyrtohen veçmas, në një rast u konstatua diskriminim në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës dhe në fushën e arsimit, ndërsa në rastin e dytë u konstatua diskriminim në fushën e anëtarësimit dhe veprimet në parti politike, shoqata, fondacione, organizata sindikaliste ose organizata të tjera mbi bazën e anëtarësimit dhe në fushën e informimit publik dhe medias.

Në rastin e parë, u konstatua **diskriminim direkt në bazë të përkatësisë etnike ndaj qytetares pjesëtare e komunitetit etnik turk** gjatë zbatimit të procedurës për punësim si mësimdhënëse në një shkollë fillore në Radovish. Përzgjedhja e shkollës, përkatësisht punësimi i një mësimdhënësi tjetër që nuk e njih gjuhën turke, kundrejt qytetares së diskriminuar që e njih gjuhën turke, përkatësisht gjuhën në të cilën mësimdhënësi do ta zhvillojë procesin mësimor, shkaktoi diskriminim edhe në bazë të gjuhës në arsimin fillor ndaj nxënësve nga e njëjta shkollë, gjuha amtare e të cilëve është turqishtja. Komisioni rekomandoi që shkolla të publikojë një shpallje të re për punësimin e mësimdhënësit dhe gjatë vendimmarrjes në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve të paraqitur ta ketë në konsideratë nenin 10 paragrafin 2 të Ligjit për arsimin fillor i cili specifikon "Për nxënësit pjesëtarë të komuniteteve të cilët mësimin e ndjekin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, procesi edukativo arsimor do të zhvillohet në gjuhën dhe alfabetin e komunitetit përkatës." dhe neni 3 paragrafi 1 pika 4 të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorë profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme i cili përcakton "Mësimdhënësi në shkollën fillore dhe të mesme mund të jetë një person që e njih gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik si dhe gjuhën dhe alfabetin në të cilën ai do ta zhvillojë procesin mësimor."

Në rastin e dytë, u konstatua ngacmim i zgjatur dhe i shumëfishtë si një lloj diskriminimi më i rëndë në bazë të përkatësisë kombëtare dhe etnike, besimit tjetër dhe statusit personal dhe shoqëror në fushën e veprimet të shoqatave, fondacioneve ose organizatave të tjera të bazuara në anëtarësim, i ushtruar nga Shoqata Qendra Kulturore "Ivan Mihajlov" Manastir ndaj anëtarëve, familjeve, mbështetësve dhe admiruesve e Lidhjes së Luftëtarëve të LNÇ-së dhe luftës antifashiste 1941-1945, ndaj popullit maqedonas dhe

pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve etnike në shoqërinë maqedonase. Në rastin e njëjtë u konstatua thirrje, nxitje dhe instruksion i zgjatur dhe i shumëfishtë për ngacmim si një lloj më i rëndë i diskriminimit në bazë të përkatësisë kombëtare dhe etnike, bindjes tjetër dhe statusit personal dhe shoqëror në fushën e medias dhe informimit publik, të kryer nga Shoqata Qendra Kulturore "Ivan Mihajlov" Manastir ndaj anëtarëve, familjeve, mbështetësve dhe admiruesve të Lidhjes së Luftëtarëve të LNÇ-së dhe luftës antifashiste 1941-1945, ndaj popullit maqedonas dhe pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve etnike në shoqërinë maqedonase. Gjithashtu u konstatua edhe diskriminim indirekt i kryer nga Ministria e Drejtësisë, për shkak të mos ushtrimit të kompetencave të saj ligjore që i mundësuan Shoqatës Qendra Kulturore "Ivan Mihajlov" Manastir të kryejë veprime të ndaluara me nenin 5 dhe 6 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, që rezultoi me llojet e lartpërmendura të diskriminimit. Komisioni rekomandoi që Shoqata të shmangë të gjitha elementet kontestuese në emërtimin, statutin dhe programin që shkaktojnë ngacmim, brenda 45 ditëve. Komisioni mes tjerash rekomandoi që Shoqata të shmangë të gjitha përmbajtjet kontestuese nga faqja e saj në rrjetin social "Facebook", të cilat shkaktojnë ngacmime dhe japin instruksione për ngacmim, në kohë sa më të shkurtër, por jo më të gjatë se 30 ditë, kurse Shoqatës në mënyrë plotësuese i rekomandoi në të ardhmen të përmbahet nga krijimi dhe shpërndarja e përmbajtjeve që mund të shkaktojë ndjejnë ngacmimi në përputhje me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Komisioni i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë brenda 45 ditëve ta mbikëqyrë ligjshmërinë dhe zbatimin e dispozitave të Ligjit për shoqata dhe fondacione në përputhje me nenin 58 të Ligjit për shoqata dhe fondacione, veçanërisht në pjesën e akteve të Shoqatës në lidhje me nenin 4 nga i njëjti, duke e pasur në konsideratë nenin 20 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Rekomandime të përgjithshme

Në tremujorin e dytë të vitit 2022, në përputhje me nenin 21 paragrafin 1 pika 5 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioni adresoi dy rekomandime të përgjithshme për çështje nga fusha e barazisë dhe mosdiskriminimit. Ato u nxitën nga parashtresat për parandalimin e diskriminimit të paraqitura nga Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve (QEDR) në Bruksel.

Rekomandimi i përgjithshëm i cili i adresohet vetëqeverisjes lokale që të sigurojë qasje të barabartë në ujë për të gjithë qytetarët me fokus të veçantë mbi komunitetin etnik rom

Në prill të vitit 2022, Komisioni një rekomandim të përgjithshëm ua adresoi komunave dhe ndërmarrjeve të tyre publike rajonale që veprojnë në fushën e aktiviteteve komunale që të sigurojnë qasje në ujë të pastër në të gjithë rajonin ku ato kanë juridiksion territoriale. Ai u nxit nga dy parashtresat e paraqitura nga Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve (QEDR) për parandalimin e diskriminimit sa i përket qasjes në ujë për qytetarët që janë pjesëtarë të komunitetit etnik rom të cilët jetojnë në lagje që nuk mbulohen nga rrjetet publike të ujësjellësit. Në rastin e parë, Komisioni konstatoi diskriminim direkt ndaj banorëve të lagjes "Teneqe Mëhallë" në rrugën "Dimkata Angelov-Gaberot" në Komunën e Kavadarit, kurse në rastin e dytë ndaj banorëve të lagjes "Debarca" dhe "Tri Bagremi" në Komunën e Prilepit.

Rekomandimi i përgjithshëm të cilin Komisioni e adresoi ka për qëllim sigurimin e qasjes së barabartë në ujë për të gjithë qytetarët dhe parandalimin e diskriminimit në të ardhmen që mungesa e ujit mund ta shkaktojë në fushat e arsimit, shëndetësisë, punësimit dhe qasjes në të mira dhe shërbime publike. Nëse ka pengesa ligjore për lidhje të rregullt në ujë përmes rrjetit komunal për furnizim me ujë, Komisioni u rekomandon autoriteteve kompetente, përmes mënyrave të përshtatshme të bazuara në praktikën

ndërkombëtare, të sigurojnë qasje të drejtpërdrejtë në ujë në ato lagje në të cilat më së shpeshti jetojnë kategori vulnerable të qytetarëve, siç është komuniteti etnik rom. Rekomandimi specifikon:

Pozita e disfavorshme e romëve, e cila është pasojë e diskriminimit sistemik që nga e kaluara, këtë komunitet në krahasim me të tjerët e bën të marginalizuar në kontekstin social. Rrjedhimisht, mungesa e qasjes adekuate në ujë të pastër është një disavantazh më i madh në raport me përmbushjen e kornizës ligjore në drejtim të përmbushjes së kushteve për legalizimin e shtëpive të tyre dhe lidhjen me rrjetet publike për furnizim me ujë. Duke e pasur parasysh faktin se qasja në ujë ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në obligimet e përditshme në lidhje me punën, shkollën, mirëmbajtjen e higjienës, reduktimin e rrezikut nga sëmundjet dhe ngjashëm, aparati shtetëror duhet të gjejë një mënyrë për të siguruar ujë të pastër në baza humanitare. Pasi të plotësohen nevojat elementare, atëherë çdo person mund të përpiqet të përfshihet në shoqëri, dhe kështu të përmbushë detyrimet qytetare, në rastin konkret, përmbushja e kritereve dhe procedurave ligjore për legalizimin e vendbanimit dhe lidhja legale në ujë. Rrjedhimisht, duke e anuluar gjendjen negative, do të zvogëlohen edhe rastet e diskriminimit ndaj komunitetit etnik rom, veçanërisht në fushën e arsimit, qasjes në të mira dhe shërbime publike dhe punësimit, raste në të cilat Komisioni paraprakisht ka konstatuar diskriminim nga ana e protagonistëve të ndryshëm në shoqëri.

Rekomandimi i përgjithshëm për eliminimin e segregacionit në arsimin fillor me fokus të veçantë mbi nxënësit romë, në mënyrë konsekuente do të respektohen aktet e rajonizimit në komuna gjatë regjistrimit të nxënësve në shkollat fillore

Në prill të vitit 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi adresoi një rekomandim të përgjithshëm deri te autoritetet kompetente që t'i respektojnë në mënyrë konsekuente aktet e rajonizimit nëpër komuna gjatë regjistrimit të nxënësve, me qëllim eliminimin e segregacionit në arsimin fillor me fokus të veçantë mbi nxënësit romë. Ai u nxit nga një parashtrësë e paraqitur nga Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve (QEDR) nga Brukseli kundër Shkollës Fillore Komunale të Komunës së Shtipit – ShFK “Goce Delçev” për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të përkatësisë etnike të nxënësve romë. Në këtë rast, në shkurt të vitit 2022, Komisioni miratoi një opinion me të cilin konstatoi diskriminim indirekt që shkakton segregacion në bazë të përkatësisë etnike në fushën e arsimit që rezulton nga dispozitat ligjore të Ligjit për arsimin fillor.

Rekomandimi i përgjithshëm i Komisionit ka për qëllim eliminimin e segregacionit në arsimin fillor, që në të ardhmen mund të çojë në intolerancë dhe diskriminim. Duke e pasur parasysh situatën faktike, legjisllacionin vendor dhe ndërkombëtar, praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe analizën e institucioneve dhe organizatave relevante të autoriteteve kompetente, rekomandohet si më poshtë:

- Organet e vetëqeverisjes lokale të ndërmarrin aktivitete për respektimin konsekuent të akteve të rajonizimit në komunat e tyre. Nga ana tjetër, rekomandohet rritja e numrit të asistentëve pedagogjikë në shkolla, gjë që do të çojë në socializmin dhe respektimin më të madh të fëmijëve, bashkëpunim më të madh midis autoriteteve komunale dhe organizatave të shoqërisë civile në lidhje me sensibilizimin e prindërve jo romë.
- Drejtorët e shkollave duhet ta shfrytëzojnë mundësinë të mos nënshkruajnë pëlqime për transferimin e nxënësve që do ta vazhdonin mësimin në një shkollë që nuk do të ishte në rajonin e tyre.

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të caktojë kriteret më të rrepta për regjistrimin e një fëmije në një rajon tjetër, gjë që do të zvogëlonte kalimin e fëmijëve në shkolla të tjera, gjë që do të kontribuonte në reduktimin e segregacionit.
- Inspektorati Shtetëror i Arsimit të kryejë kontroll mbi procesin e regjistrimit të nxënësve në institucionet arsimore dhe mbi mënyrën e përfshirjes së nxënësve në përputhje me rajonizimin e shkollave fillore të themeluara nga komunat dhe Qyteti i Shkupit në përputhje me nenin 28 dhe nenin 29 të Ligjit për inspeksionin arsimor.

Në Rekomandimin specifikohet si më poshtë:

Sipas LPMD-së, segregacioni si formë diskriminimi, në nenin 12 përcaktohet si ndarje fizike e personit ose grupit të personave mbi bazë diskriminuese pa një qëllim legjitim ose të justifikuar objektivisht. Nga përkufizimi dhe problemi shoqëror i përshkruar më sipër, konfirmohet se prindërit nuk kanë një qëllim legjitim dhe objektivisht të justifikuar për t' i regjistruar fëmijët e tyre jashtë rajoneve ku ata jetojnë. Përbërja etnike e fëmijëve në shkolla të ndryshme në të gjithë vendin vë në dukje faktin se këto nuk janë raste individuale midis prindërve, por ndarje e vetëdijshme e fëmijëve të tyre nga fëmijët e përkatësisë etnike rome. Një kontekst i tillë mund të lërë pasojë të thella jo vetëm tek fëmijët e përkatësisë etnike rome, por edhe tek fëmijët jo-romë, sepse mungesa e mundësive dhe rasteve për fëmijët me prejardhje të ndryshme kulturore dhe etnike për t' u integruar dhe mësuar për njëri-tjetrin, në të ardhmen mund të çojë në intolerancë dhe diskriminim nga grupi "më i fortë ose me numër më të madh".

Statuasi i përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit

Në bazë të nenit 21 paragrafi 1 pika 17 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioni e monitoron realizimin e opinionëve dhe rekomandimeve për rastet konkrete të diskriminimit deri në përmbushjen e rekomandimeve të adresuara nga Komisioni. Personi të cilit i adresohet rekomandimi e ka për detyrë ta trajtojë rekomandimin dhe ta evitojë shkëlqen e së drejtës brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të rekomandimit ose brenda një afati më të gjatë nëse ka arsye veçanërisht të justifikuara, por jo më shumë se gjashtë muaj, dhe për këtë ta njoftojë Komisionin.

Në periudhën raportuese, përfundimisht me datë 31.12.2022, Komisioni konstatoi se rekomandimet janë përmbushur, përkatësisht, **diskriminimi u evitua në gjithsej 16 raste që u konstatuan në 2022.**

Për 34 raste që u konstatuan në vitin 2022, Komisioni nuk pranoi njoftim me shkrim nga diskriminuesi i përcaktuar pas skadimit të afatit të parashikuar ligjor për trajtimin e rekomandimit në fjalë

Komisioni vazhdon ta monitorojë implementimin e rekomandimeve për 20 parashtresat e tjera, afati për trajtimin i të cilave është viti 2023.

Kërkesa për iniciimin e procedurave për kundërvajtje

Në bazë të nenit 27 paragrafi 4 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, nëse personi të cilit i adresohet rekomandimi nuk vepron ndaj rekomandimit, Komisioni paraqet kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje pranë gjykatës kompetente për kundërvajtje.

Në vitin 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi paraqiti **14 kërkesa për iniciimin e procedurave për kundërvajtje** kundër diskriminuesve të caktuar, të cilët nuk vepruan sipas rekomandimeve të Komisionit brenda afatit të parashikuar ligjor.

4 nga 14 kërkesat e paraqitura u hodhën poshtë me aktvendime të gjykatave kompetente. Për 2 nga këto 4 aktvendime, Komisioni ka paraqitur ankesa në gjykatat e apelit. Një nga ankesat u hodh poshtë për shkak të shkeljes së afatit, ndërsa një u hodh poshtë si e pabazë.

Një kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje u revokua nga Komisioni me qëllim të përmbushjes së rekomandimit, nga opinioni i miratuar, nga ana e diskriminuesit.

Për 9 kërkesat e paraqitura për iniciimin e procedurës për kundërvajtje, gjykatat iniciuan procedura për kundërvajtje. Në kuadër të këtyre procedurave, u miratua 1 aktgjykim i shkallës së parë me të cilin shpallen fajtor personat juridikë dhe fizikë për kundërvajtje të kryera sipas nenit 6, nenit 8, paragrafi 1, e dënueshme sipas nenit 41, paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. 8 nga 9 procedurat për kundërvajtje janë në rrjedhë e sipër.

Problemet dhe sfidat më të shpeshta me të cilat ballafaqohet Komisioni në lidhje me procedurën procesuale për kundërvajtje konsistojnë me atë se gjykatat në disa procedura i qasen vendimmarrjes materiale lidhur me atë se a ka diskriminim në rastin konkret, me ç'rast në mënyrë të drejtpërdrejtë çrregullohet dhe rrenohet pavarësia në punën e Komisionit dhe aspekti final i opinionëve të cilat i miraton institucioni.

Opinione profesionale

Opinionit profesional në lidhje me terminologjinë e përdorur në materialin për arsimin formal, kapitulli i përgatitur nga teksti shkollor Stomatologjia pediatrike, me titull Mbrojtja dentare e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Në maj të vitit 2022, në përputhje me nenin 21 paragrafin 1 pikën 4 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, pas një kërkesë të paraqitur për adresimin e opinionit profesional, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi miratoi **Opinion profesional mbi terminologjinë e përdorur në materialin për arsimin formal, kapitulli i përgatitur nga teksti shkollor Stomatologjia pediatrike, me titull Mbrojtja dentare e fëmijëve me aftësi të kufizuara.**

Kërkesa adresuar deri te Komisioni për miratimin e opinionit profesional për përdorimin e terminologjisë në kapitullin e theksuar të tekstit shkollor Stomatologjia pediatrike është në drejtimin e asaj se i njëjti a përmban terminologji të vjetruara dhe gjuhë ngacmuese në bazë të aftësisë së kufizuar dhe a është në përputhje me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për një kërkesë specifike, përgjigjja e së cilës kërkon ekspertizë të veçantë dhe plotësuese, ndërkaq për ta trajtuar në mënyrë profesionale dhe efektive, Komisioni, në përputhje me nenin 21 paragrafin 23 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, mori vendim të formojë një organ të përkohshëm këshillimor për përpilimin e opinionit profesional duke përfshirë ekspertë të jashtëm për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara nga shoqata e qytetarëve Polio Plus – lëvizja kundër handikapit.

Në bazë të gjetjeve të analizës së terminologjisë së përdorur në materialin për arsimin formal, në kapitullin e përgatitur nga teksti shkollor Stomatologjia pediatrike, me titull Mbrojtja dentare e fëmijëve me aftësi të kufizuara, Komisioni ofron opinion profesional dhe rekomandime për korigjimin e tekstit dhe harmonizimin e tij me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si vijon:

- të përdoret klasifikimi i llojeve të aftësisë së kufizuar në përputhje me nenin 1 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;

- të mos bëhet identifikimi i një sëmundjeje me gjendjen e aftësisë së kufizuar. Ky identifikim përbën ngacmim në bazë të aftësisë së kufizuar sipas kuptimit të nenit 9 të LPMD-së;

- të korrigjohen pjesët e tekstit që specifikojnë nevoja dhe vëmendje të veçantë gjatë punës me fëmijë me aftësi të kufizuara, të cilat janë të nevojshme edhe gjatë punës me fëmijët pa aftësi të kufizuara, siç është komunikimi i mirë i dentistit me fëmijët me aftësi të kufizuara, krijimi i marrëdhënieve miqësore, mbështetja dhe simpatia nga fëmijët dhe shfaqja e hiperaktivitetit, ankthit, reagimeve të paparashikueshme dhe mbajtjes së vëmendjes për një kohë të shkurtër. Këto karakteristika janë tipike për të gjithë fëmijët, pavarësisht nëse ata janë me aftësi të kufizuara apo jo.

Opinion i profesional në lidhje me Propozim-Ligjin për nëpunësit administrativë i postuar në Regjistrin Unik Elektronik Kombëtar të akteve normative (RUEK) – Tetor 2022

Në nëntor të vitit 2022, në përputhje me nenin 21 paragrafin 1 pikën 11 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi miratoi **Opinion profesional lidhur me Propozim-Ligjin për nëpunësit administrativë të postuar në Regjistrin Unik Elektronik Kombëtar të akteve normative (RUEK) – Tetor 2022.**

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi se Propozim-Ligji për nëpunësit administrativë përmban dispozita diskriminuese në nenin 71, i cili i rregullon pagat e nëpunësve administrativë të punësuar në ministritë dhe sekretariate në mënyra të ndryshme, kundrejt nëpunësve administrativë të punësuar në institucionet e sektorit publik.

Në përputhje me nenin 3 të këtij propozim-ligji, nëpunës administrativ është çdo person që ka themeluar marrëdhënie pune me qëllim kryerjen e punëve administrative në ndonjë nga institucionet e mëposhtme:

- organet e pushtetit qendror dhe lokal dhe organet e tjera shtetërore të themeluara në përputhje me Kushtetutën dhe me ligj; dhe
- institucionet që kryejnë veprimtari në fushën e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, punës, mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, sportit, si dhe në veprimtari të tjera me interes publik të përcaktuara me ligj, ndërkaq të organizuara si agjenci, fondacione, institucione publike dhe ndërmarrje publike të themeluara nga Republika e Maqedonisë ose nga komunat, nga Qyteti i Shkupit, si dhe nga komunat në Qytetin e Shkupit.

Gjatë analizës së tekstit integral të propozim-ligjit, Komisioni vë në dukje se disa dispozita të ligjit, nëse miratohen si të tilla, do të krijojnë pozitë të pabarabartë për pjesën më të madhe të nëpunësve administrativë në raport me pjesën tjetër të nëpunësve administrativë.

Me këtë dispozitë të propozuar, nëpunësit administrativë të punësuar në ministritë dhe sekretariate do të kishin një shumë dukshëm më të lartë të pagës së përcaktuar bazë në krahasim me nëpunësit administrativë në të gjitha institucionet e tjera të sektorit publik, megjithëse kanë të njëjtin status të nëpunësit administrativ, të sistematizuar në të njëjtin nivel, përkatësisht i plotësojnë të njëjtat kushte të përgjithshme dhe të veçanta për nivelin e caktuar.

Në këtë kuptim, dispozita e përcaktuar në këtë mënyrë do të çonte në diskriminim direkt në përputhje me nenin 8 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, përkatësisht, një grup personash do të trajtohej në mënyrë të pafavorshme në krahasim me një grup tjetër personash në një situatë faktike ose mundësisht të krahasueshme apo të ngjashme, në bazë diskriminuese. Rrjedhimisht, nëpunësit administrativë të punësuar në institucione të tjera të sektorit publik do të trajtohen në mënyrë të pafavorshme në krahasim me nëpunësit administrativë të punësuar në ministritë dhe sekretariate në të njëjtin nivel në bazë të marrëdhënies së punës të themeluar me punëdhënësin.

Propozuesi i ligjit nuk u përpoq ta shpjegojë dhe justifikojë motivin e konceptit të këtillë të trajtimit të pabarabartë gjatë pikëzimit të nëpunësve administrativë në nivele të njëjta, në bazë të institucionit në të cilin ata e kanë themeluar marrëdhënien e punës, gjë që vë në dukje se kriteri i tillë nuk mund të konsiderohet i justifikuar dhe objektiv. Mungesa e qëllimit legjitim të vlerësimit të diferencuar të punës do të rezultojë në ndryshime të konsiderueshme sa u përket pagave të nëpunësve administrativë që punojnë në vende pune të të njëjtit nivel, në kundërshtim me dispozitat e përfshira në nenin 7 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

Në përputhje me këtë që u tha më lart, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi vë në dukje se në Propozim-Ligjin për nëpunësit administrativë, neni 71 që e rregullon përlogaritjen e pagës bazë të nëpunësve administrativë, nëse miratohet në këtë formë, do të krijojë kushte për trajtim të pabarabartë të një numri të madh të nëpunësve administrativë të punësuar në institucionet e sektorit publik, të cilët do të vihen në pozitë të pafavorshme në krahasim me nëpunësit administrativë të punësuar në ministritë dhe sekretariate në të njëjtin nivel, që nënkupton diskriminim direkt të kryer nga autoritetet publike ndaj këtij grupi punonjësish. Ky propozim është në kundërshtim me konceptin "pagë e njëjtë për punë me vlerë të njëjtë", si dhe me ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit të specifikuar në Kushtetutë, Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe në një numër të madh instrumentesh të ratifikuara ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të cilat, sipas nenit 118 të Kushtetutës, janë pjesë e rendit të brendshëm juridik.

Nëse miratohet një propozim-ligj i këtillë, atëherë institucionet e sektorit publik do të ballafaqohen me një motivim të reduktuar midis punonjësve të tyre, gjë që do të ndikonte drejtpërdrejt në efikasitetin dhe efektivitetin e funksionimit të këtyre institucioneve. Përveç kësaj, dispozitat e këtilla do të ndikonin negativisht në mobilitetin e punonjësve të sektorit publik, duke çuar në mungesë të mundshme të fuqisë së punës në pjesën më të madhe të institucioneve të sektorit publik. Në planin afatgjatë, ekziston rreziku i krijimit të pabarazisë strukturore që do ta pamundësojë realizimin e barazisë materiale të qytetarëve si qëllim përfundimtar i çdo shoqërie demokratike.

Opinionin profesional, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi ia dërgoi Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës.

Pjesëmarrja e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi si "mik i gjykatës" (amicus curiae) në procedurën gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi me interes publik (actio popularis)

Në shtator të vitit 2022, Gjykata Civile në Shkup nxori aktgjykim të shkallës së parë sipas padisë me interes publik (actio popularis), me të cilin përcaktohet diskriminim ndaj personave me aftësi të kufizuara sa i përket qasjes së tyre në vendet zgjedhore. Kjo është procedura e parë gjyqësore në të cilën Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi e përdori institutin "mik i gjykatës" (amicus curiae) dhe kontribuoi në procedurën.

Në përputhje me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi mund të iniciojë dhe të paraqitet si bashkëbisedues në procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi ose, me kërkesë të palës apo me iniciativën e vet, të paraqesë kërkesë që gjykata t'ia mundësojë dhe të veprojë si mik i gjykatës (amicus curiae). Amicus curiae ose mik i gjykatës është një person profesional, organizatë ose organ që nuk është palë në procedurat gjyqësore, por me ekspertizën, përvojën dhe informacionet e tij në një fushë të veçantë mund të këshillojë gjykatën për një çështje të veçantë juridike, e cila është objekt i procedurës gjyqësore. Në prill të vitit 2021, Komisioni për herë të parë përdori kompetencën e tij ligjore dhe kërkoi nga Gjykata Themelore Civile Shkup t'ia mundësojë të veprojë si mik i gjykatës në procedurën gjyqësore të iniciuar nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut – Shkup kundër Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për diskriminim direkt ndaj personave me aftësi të kufizuara gjatë realizimit të së drejtës së tyre të votës. Komisioni, si një autoritet profesional për barazi, bëri një interpretim të neneve të Konventës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në lidhje me përshtatjen adekuate, qasjen e përgjithshme, barazinë dhe mosdiskriminimin në lidhje me aksesin në vendet e votimit dhe mundësinë që personat me aftësi të kufizuara ta realizojnë të drejtën e votës në mënyrë të barabartë me të tjerët, si pjesë përbërëse në jetën politike dhe publike. Për më tepër, Komisioni në parashtrimin e tij bëri një pasqyrë të shkurtër të praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për çështjet në të cilat Gjykata konstatoi diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar për shkak të mungesës së përshtatjes adekuate.

Përveç kësaj çështje, Komisioni paraprakisht në vitin 2021 veprroi edhe sipas iniciativës së tij, kurse sipas informacionit (dyshimit të bazuar) të liferuar nga një person me aftësi të kufizuara fizike, i cili u ankua se nuk mund ta depozitonte nënshkrimin e tij në mbështetje të një liste të caktuar të pavarur të kandidatëve për zgjedhjet lokale në vitin 2021, inicioi procedurë për mbrojtje nga diskriminimi kundër Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Gjegjësisht, [në gusht të vitit 2021, Komisioni konstatoi diskriminim të zgjatur direkt në bazë të aftësisë së kufizuar gjatë pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ndaj personave me aftësi të kufizuara fizike](#), për shkak të infrastrukturës së pa përshtatur e cila personave me aftësi të kufizuara fizike ua pamundëson aksesin në objektet e Njesisë Rajonal të KSHZ – Karposh dhe në këtë mënyrë pamundësohet aksesin përkatësisht hyrje-dalja e personave me aftësi të kufizuara fizike në mënyrë të barabartë me personat e tjerë. Duke e pasur parasysh se çështjet e aksesit dhe përshtatjes së duhur të zyrave rajonale të KSHZ-së ndikojnë në pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike të një numri të konsiderueshëm të qytetarëve, përkatësisht se këto çështje janë me interes

publik, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi për këtë lëndë miratoi [Rekomandim të përgjithshëm](#).

Aktivitetet e realizuara të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi

Konferenca e 6-të Rajonale e Organeve të Barazisë në Evropën Juglindore

Në periudhën kohore prej 5-7 shtator 2022, në Shkup u mbajt Konferenca e 6-të Rajonale e Organeve të Barazisë në Evropën Juglindore. Konferenca u organizua nga Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, me mbështetje financiare nga Misioni i OSBE-së në Shkup, ku morën pjesë përfaqësues të organeve për barazi të Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjë e Hercegovinës, Malit të Zi, Serbisë, Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe një numër i madh i përfaqësuesve të institucioneve kombëtare, organizatave, partnerëve dhe ekspertëve që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Në fokus të diskutimit të Konferencës ishin temat që kanë të bëjnë me rolin e organeve të barazisë në procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, të cilat zhvillohen para gjykatave vendore dhe ndërkombëtare, si dhe kalimi i barrës së provës në procedurat gjyqësore dhe procedurat para organeve të barazisë.

Pjesëmarrësit e Konferencës së 6-të Rajonale riafirmuan nevojën për bashkëpunim dhe rrjetëzim më intensiv të ndërsjellë të organeve të barazisë dhe institucioneve rajonale për të drejtat e njeriut për shkëmbimin më të madh të përvojës dhe shembujve konkretë të veprimit në raste të caktuara, të cilat do t'u vinë në ndihmë organeve me praktikë më pak të zhvilluar, ta rrisin efikasitetin e tyre në ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore. Veçanërisht ato që kanë të bëjnë me trajtimin e parashtrësive nga qytetarët dhe personat juridikë, në dhënien e opinioneve, rekomandimeve dhe këshillave për iniciimin e procedurave gjyqësore ose procedurave të tjera ligjore para instancave vendase dhe ndërkombëtare, si dhe në ushtrimin e funksionit të tyre preventues dhe arsimor në parandalimin dhe mbrojtjen nga të gjitha llojet e diskriminimit në shoqëri. Së këtëjmi u miratuan **konkluzione dhe rekomandime** si më poshtë :

Konkluzione

1. Organet e barazisë përdorin konteste gjyqësore strategjike për të sqaruar ligjin, në drejtim të zbatimit të duhur të legjislacionit kombëtar dhe standardeve ndërkombëtare.
2. Kriteret për kontestet gjyqësore strategjike, të zhvilluara nga organet e barazisë, ndihmojnë në përzgjedhjen e rasteve dhe në mbrojtje nga subjektiviteti potencial.
3. Përveç kontesteve gjyqësore strategjike, opinionet e përgjithshme (rekomandimet) mund të ndihmojnë në luftën kundër diskriminimit sistematik. Nga ana tjetër, inkurajohet përdorimi i instrumenteve të reja kreative lidhur me provat, siç është testimi i situatës dhe statistikave, nga organet e barazisë në rastet gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi.
4. Për të arritur efektin e zgjerimit përkatësisht efektin e valëzimit nga rastet e suksesshme gjyqësore, organet e barazisë shpesh përdorin mekanizma komunikimi dhe ndërtojnë aleanca me shoqërinë civile, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, partnerët socialë dhe sektorin privat.

Rekomandime /Pikat e Veprimit

1. Përdorimi më aktiv i kontesteve strategjike gjyqësore
2. Intensifikimi i bashkëpunimit me instancat më të larta gjyqësore, institucionet e trajnimit të gjyqësorit dhe inspektorateve
3. Inkurajimi i bashkëpunimit me organizatat qytetare dhe mediat si një nga mënyrat e përballimit me raportimin e pamjaftueshëm

Kontributi në konsultat e Komisionit Evropian lidhur me standardet e Organeve të Barazisë

Raportimi dhe avokimi ndërkombëtar

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi e dërgoi kontributin e tij në konsultat e Komisionit Evropian për hartimin e standardeve të organeve të barazisë. Në dokumentin e tij KPMD e nënvizoi rëndësinë e të pasurit organe të fuqishme dhe efektive të barazisë për luftimin e diskriminimit dhe promovimin e parimit të barazisë, garantimin e pavarësisë së organeve të barazisë, qasjen në shërbimet e organeve të barazisë për të gjithë qytetarët dhe ndikimin e standardeve detyruese minimale lidhur me fuqizimin e organeve të barazisë dhe sigurimin e pavarësisë dhe efikasitetin e tyre.

Kontributi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në Raportin e 4-të ndaj Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në hartimin e **Raportit të 4-të të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)**. Në kontributin e tij, Komisioni informoi për masat legjislative dhe masat e tjera të marra gjatë periudhës raportuese për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të orientimit seksual, seksit, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, statusit socio-ekonomik, moshës, racës, përkatësisë etnike, fesë, statusit të HIV dhe/ose kombësisë. Njëkohësisht, Komisioni raportoi lidhur me zbatimin e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe për të gjitha hapat e ndërmarra për sigurimin e funksionimit të pavarur dhe efektiv të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioni raportoi edhe për segregacionin e fëmijëve romë në arsim. Komiteti u informua për diskriminimin e konstatuar indirekt që shkakton segregacion të fëmijëve romë në dy shkolla në qytetet Shtip dhe Manastir, bazuar në përkatësinë etnike në fushën e arsimit, që buron nga dispozitat e Ligjit për arsimin fillor, si dhe për rekomandimin e përgjithshëm për desegregimin e fëmijëve romë në arsim, i cili u rekomandon autoriteteve kompetente të vetëqeverisjes lokale të ndërmarrin aktivitete për respektimin konsekuent të akteve për rajonizimin në komunat e tyre, të cilat do të synonin desegregimin e fëmijëve romë.

Ditët e Hapura të KPMD-së për Barazi dhe Mosdiskriminim

Nën moton IDENTIFIKO, DENONCO, PARANDALO DISKRIMINIMIN, në periudhën kohore nga 12 shtatori deri më 23 shtator 2022, në shtatë qytete u mbajtën ditë të hapura me temën BARAZIA dhe MOSDISKRIMINIMI. Qëllimi i aktiviteteve ishte prezantimi i kompetencave të Komisionit para qytetarëve dhe mundësia e tyre për të komunikuar drejtpërdrejt me anëtarët e Komisionit dhe punonjësit e shërbimit profesional për çështjet në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë dhe mos diskriminimit. Ngjarjet u mbështetën nga Misioni i OSBE-së në Shkup dhe u realizuan sipas orarit në vijim:

- 12.09.2022 në Tetovë
- 13.09.2022 në Kumanovë,
- 19.09.2022 në Manastir
- 20.09.2022 në Ohër
- 21.09.2022 në Strumicë
- 22.09.2022 në Shtip
- 23.09.2022 në Veles

Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Memorandume bashkëpunimi

1. Në shkurt të vitit 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me organizatën qytetare **Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar**, i cili deklaroi interesin e të dy palëve për të dhënë një kontribut të përbashkët në forcimin e rolit të KPMD-së në respektimin e të drejtave të qytetarëve që trajtohen në mënyrë të pabarabartë përmes zbatimit të projektit "Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi kryen rolin e tij parandalues dhe mbrojtës", financuar nga Bashkimi Evropian nga 1 janari 2022 deri më 31 dhjetor 2023. Bashkëpunimi midis KPMD-së dhe QMBN-së përfshin shkëmbimin e të dhënave, pjesëmarrjen në takime, punëtori, trajnime, vizita studimore, tryeza të rrumbullakëta, konferenca, hartimin e raporteve dhe forma të tjera të bashkëpunimit për të cilat palët do të bien dakord, ndërsa do të rezultojnë nga nevojat aktuale të Projektit. Në kuadër të Projektit do të përgatitet edhe një "Barometër për të Drejtat e Njeriut dhe Anti-Diskriminim".
2. Në mars të vitit 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Zyra e Komisionerit të Lartë pranë Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi për të forcuar partneritetin e tyre strategjik. Të dyja organizatat do të vazhdojnë të mbështesin të drejtat e personave në mandatin e UNHCR në vend, përmes partneritetit në fushën e mbrojtjes, komunikimit, afrimit me komunitetin, si dhe në transformimin e narracionit për azilkërkuesit, refugjatët, personat nën mbrojtje subsidiare dhe personat në rrezik të pashtetësisë. KPMD-ja obligohet të intervenojë në rastet e diskriminimit ndaj këtyre individëve dhe do të përqendrohet në promovimin e trajtimit të barabartë të të gjithë personave.
3. Në mars të vitit 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe **Ministria e Brendshme** nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi, qëllimi kryesor i të cilit është të sigurojë të dhënat e nevojshme në dispozicion, të cilat i përpunon Ministria e Brendshme, në mënyrë që të sigurojë një kontribut të përbashkët për fuqizimin e rolit të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi në respektimin e të drejtave të qytetarëve, që trajtohen në mënyrë të pabarabartë. Krijohet një kornizë në të cilën do të zhvillohet partneriteti i ndërsjellë në disa segmente, kryesisht në fushën e shkëmbimit cilësor dhe efikas të informacioneve, të dhënave, përvojave, njohurive, edukimit dhe trajnimit, si dhe realizimit të llojeve të tjera të bashkëpunimit në përputhje me kompetencat e përcaktuara ligjërish të të dy institucioneve. Në kuptimin operacional, përveç specifikimit të shkëmbimit të informacioneve dhe të dhënave, Memorandumi i Bashkëpunimit parashikon një sërë formash të ndryshme të veprimit të përbashkët – siç janë ngjarjet e përbashkëta, përgatitja e përbashkët e analizave të raporteve dhe forma të tjera të bashkëpunimit në të cilat lihet hapësirë edhe për angazhimin e ekspertëve të jashtëm, në mënyrë

- që të sigurohet funksionimi cilësor i Komisionit në fushën e kompetencave ku pjesëmarrja e Ministrisë së Brendshme është gjithashtu e nevojshme.
4. Në mars të vitit 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me **Këshillin e Etikës në Media** i cili parashikon veprim dhe bashkëpunim të përbashkët në interes të promovimit të barazisë dhe luftimit të të gjitha formave të diskriminimit. Qëllimi i bashkëpunimit është ngritja e vetëdijes së qytetarëve për pasojat e dëmshme nga diskriminimi dhe vokabulari ngacmues në sferën publike, por edhe promovimi i raportimit të pavarur, profesional dhe etik në media, të liruar nga paragjykimi dhe gjuha diskriminuese, gjuha ngacmuese, si dhe nga gjuha që provokon ose inkurajon diskriminim. Aktivitetet arsimore do të iniciohen dhe inkurajohen bashkërisht, me qëllim të ngritjes së njohurive dhe të kuptuarit e gazetarëve dhe punonjësve të medias për identifikimin e diskriminimit dhe pasojave të tij, si dhe mënyrat për ta parandaluar atë, por edhe për të zhvilluar forma të mbështetjes dhe mbrojtjes së gazetarëve dhe përfaqësuesve të medias të cilëve u adresohet gjuha ngacmuese dhe diskriminimi.
 5. Në prill të vitit 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe **Instituti për Kërkime dhe Analiza të Politikave "Romalitiko"**, nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi. Qëllimi i nënshkrimit të këtij dokumenti është promovimi, zhvillimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm në lidhje me barazinë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe eliminimin e të gjitha llojeve të diskriminimit në përputhje me interesat dhe objektivat e përbashkëta të të dy subjekteve. Me Memorandumin parashikohet si vijon: KPMD-ja do t'i caktojë përfaqësuesit e saj në takimet informuese të organizuara në zyrat e Romalitiko në mbarë vendin, ku qytetarët e komunitetit etnik rom do të njoftohen në mënyrë të drejtpërdrejtë me punën e tyre dhe do t' i informojnë se si ta denoncojnë diskriminimin. Përveç kësaj, Komisioni dhe Romalitiko do të shkëmbejnë informacion periodik në lidhje me lëndët që kanë të bëjnë me diskriminimin e adresuar komunitetit etnik rom.
 6. Në prill të vitit 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe **Fakulteti Juridik pranë Universitetit "Shën Kliment Ohridski" – Manastir**, nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi. Qëllimi i nënshkrimit të këtij dokumenti është vendosja e bashkëpunimit afatgjatë shkencor, profesional, arsimor dhe aplikativ ndërmjet palëve kontraktuese.
 7. Në qershor të vitit 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me **Shoqatën për Pakicat Seksuale dhe Gjinore "Fronti Subversiv"** me qëllim të mbështetjes së përpjekjeve për luftimin e gjuhës diskriminuese dhe dukurive të tjera negative në internet, me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
 8. Në qershor të vitit 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me Institutin për Qeverisje të Mirë dhe Perspektiva Euro-Atlantike – IQMPE, me qëllim të realizimit të përpjekjeve të përbashkëta për të forcuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e ndërsjellë në përpjekjet për ta luftuar gjuhën diskriminuese dhe dukuritë e tjera negative në hapësirën e internetit. Ai krijon një kornizë për bashkëpunim të ndërsjellë për të ndërmarrë aktivitete të përbashkëta të koordinuara për të promovuar mbrojtjen dhe sigurimin e gëzimit të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut të të gjithë qytetarëve, avokim të përbashkët publik në temën që lidhet me luftën kundër gjuhës diskriminuese dhe zbatimin e aktiviteteve dhe fushatave të përbashkëta mediatike, dhe ngjashëm.

9. Në korrik të vitit 2022, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhi një Memorandum Bashkëpunimi me **Kabinetin e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut**. Qëllimi i Memorandumit është që nën patronazhin e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut Stevo Pendarovski, kurse përmes vendosjes së kornizës për bashkëpunim me Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndërmerren veprime të koordinuara për promovimin e mbrojtjes dhe sigurimin e gëzimit të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë qytetarët.

Fuqizimi i kapaciteteve të KPMD-së

Në periudhën kohore nga 27 shtatori deri më 6 tetor 2022, u realizua një vizitë studimore e anëtarëve dhe punonjësve të shërbimit profesional të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMD) në Londër, Angli dhe Belfast, Irlandën e Veriut. Qëllimi i vizitës ishte të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve dhe shërbimit të KPMD-së duke e transferuar ekspertizën me përfaqësuesit relevantë në fushën e barazisë, të drejtave të njeriut dhe anti-diskriminimit në Mbretërinë e Bashkuar. Gjatë vizitës, KPMD-ja mori pjesë në takimet dhe prezantimet e mëposhtme:

- Prezantimi i pasqyrës së punës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut në Skoci dhe procesi i inkorporimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në legjislacionin e Skocisë;
- Prezantimi i Standardeve dhe Mekanizmave Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Diskriminimit;
- Prezantimi mbi rolin, strukturën dhe punën e Komisionit për Barazi dhe të Drejtat e Njeriut (KBDNj) në Londër, i cili është përgjegjës për Anglinë, Uellsin dhe Skocinë dhe nuk ka kompetenca në Irlandën e Veriut;
- Vizitë në Komitetin Parlamentar për Gratë dhe Barazi dhe një takim pune me përfaqësuesin e Komitetit Parlamentar për Gratë dhe Barazi në Mbretërinë e Bashkuar.
- Vizitë dhe takim pune me Zyrën Qeveritare për Barazinë e Politikave dhe Legjislacionin;
- Prezantimi mbi Punën e Fondacionit "Runnymede Trust" lidhur me promovimin e barazisë racore;
- Prezantimi mbi rolin dhe punën e Komisionit të Barazi në Irlandën e Veriut
- Prezantimi nga zyrtarët e lartë të Zyrës Ekzekutive (Kabineti Qeveritar) të Irlandës së Veriut.
- Prezantimi mbi buxhetimin gjinor në Irlandën e Veriut
- Roli dhe puna e Avokatit të Popullit në Irlandën e Veriut

Vizita studimore u organizua në kuadër të bashkëpunimit të përbashkët ndërmjet Projektit "Lufta kundër diskriminimit përmes mbështetjes së KPMD-së" të mbështetur financiarisht nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Shkup, ndërkaq i implementuar nga Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve dhe Projektit "Komisioni kundër diskriminimit e kryen rolin e tij parandalues dhe mbrojtës" të mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian, ndërsa të implementuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Prezenca e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi në Media

Për sa i përket vizibilitetit në media dhe në publik, KPMD-ja pati një vit të mirëfilltë aktiv.

Komisioni në vitin 2022 mbajti pesë konferenca për shtyp.

Në maj, KPMD-ja realizoi një konferencë për shtyp për ta prezantuar Raportin e tremujorit të parë të vitit, ku paraqiti të dhënat se në periudhën e specifikuar, Komisioni veproi ndaj gjithsej 95 parashtresave, nga të cilat 57 janë parashtruar në tremujorin e parë të vitit 2022, dhe pjesa tjetër janë nga viti 2021. Në këtë raport është theksuar se fusha më shumë e përfaqësuar ku është konstatuar diskriminim është fusha e medias, me ç'rast janë miratuar opinione për 13 raste.

Me rastin e 8 prillit, Ditës Ndërkombëtare të Romëve, KPMD-ja në një konferencë për shtyp konstatoi se akoma ekziston diskriminimi racor në shtetin tonë, i cili kryesisht synon bashkëqytetarët tanë pjesëtarë të komunitetit rom. Diskriminim ndaj këtij komuniteti etnik, KPMD-ja ka detektuar përmes shembujve të segregacionit në vendbanime, segregacionit të fëmijëve romë në shkollat fillore, mospasjes qasje të grave romë në mbrojtjen shëndetësore dhe shërbimet gjinekologjike, mospasjes qasje në ujë në disa lagje të caktuara romë, mospasjes qasje në të mira dhe shërbime sociale. Në këtë konferencë për shtyp, u prezantuan raste në të cilat janë përmbushur rekomandimet e miratuara nga KPMD-ja.

Komisioni mbajti një konferencë për shtyp për nxënësit me aftësi të kufizuara nga Gostivari, me ç'rast e arsyetoi Opinionin e miratuar, i cili konstaton segregacion dhe përjashtim nga procesi arsimor të nxënësve me sindromën Down, si dhe diskriminimin të zgjatur direkt për shkak të infrastrukturës së papërshtatur shkollore. Në këtë rast, rekomandimet e prezantuara nga KPMD-ja u respektuan plotësisht.

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi në tetor të vitit 2022 në një konferencë për shtyp publikoi Opinionin dhe Rekomandimet në lidhje me parashtresën e parashtruar kundër Shoqatës "Qendra Kulturore Ivan Mihajlov - Manastir" për diskriminim në bazë kombëtare dhe etnike ndaj popullit maqedonas dhe pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në fund të muajit nëntor, Komisioni para mediave e prezantoi opinionin e miratuar në lidhje me Ligjin për nëpunësit administrativë, në të cilin konstaton se Propozim-ligji për nëpunësit administrativë përmban dispozita diskriminuese në nenin 71, i cili i rregullon pagat e nëpunësve administrativë të punësuar në ministrinë dhe sekretariate në mënyra të ndryshme, kundrejt nëpunësve administrativë të punësuar në institucionet e sektorit publik.

Komisioni, në vitin 2022, mediave u dërgoi pesëmbëdhjetë njoftime me informacione në lidhje me punën e tij.

Anëtarët e KPMD-së kanë marrë pjesë në mbi dhjetë emisione të ndryshme, pyetjeve të gazetarëve u janë përgjigjur me shkrim dhe kanë dhënë deklarata.

Në segmente të ndryshme, Komisioni është cituar në mediat e shkruara dhe elektronike më shumë se 70 herë, ndërsa artikuj gazetaresk në lidhje me aktivitetet konkrete të KPMD-së janë botuar përafërsisht pesëdhjetë herë.

Ka mbi njëqind artikuj të publikuar në faqen e INTERNETIT dhe profilin Facebook të KPMD-së, duke e përfshirë shënimin e datave me rëndësi botërore në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimin.

Buxheti, llogaria përfundimtare dhe financimi

Në vitin 2022, Buxheti i Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili udhëhiqet si Programi 20, është projektuar në një shumë të përgjithshme prej 15.320.000,00 denarë.

Për të zbatuar në mënyrë më efektive programin e punës të Komisionit, prioritetet strategjike dhe aktivitetet e planifikuara për vitin 2022, si dhe për të mundësuar funksionim pa pengesa të Shërbimit profesional, gjatë vitit, u imponua nevoja për ridedikime të caktuara, si më poshtë: ridedikimi i zërave 483 - blerja e mobileve, 425 - shërbimet kontraktuese, 464 - transfertat të ndryshme dhe 404 - kompensime.

Me rishikimin e buxhetit, të votuar nga Kuvendi, në programin 20 – Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë shtuar 4.000.000,00 denarë, edhe atë në këto zëra: paga dhe kompensime - 2.000.000 denarë, mallra dhe shërbime - 1.560.000 denarë dhe në zërin për shpenzime kapitale - 440.000 denarë.

Në vazhdim është pasqyra tabelare e mjeteve të akorduara, të planifikuara dhe të shpenzuara sipas zërave, gjatë vitit 2022:

Përshkrimi i pjesëve të Buxhetit	Numri i zërit	Buxheti	Plani	Mjete të shpenzuara	% realizim
Pagat themelore	401	9.528.000,00	8.918.032	8.918.032,00	93,60%
Kontribute për sigurimin social	402	3.542.000,00	3.464.106,00	3.464.106,00	97,80%
Kompensime	404	120.000,00	99.000,00	99.000,00	82,50%
Shpenzimet e udhëtimit dhe ditore	420	750.000,00	750.000,00	570.828,00	76,11%
Shërbimet komunale, ngrohja, komunikimi dhe transporti	421	1.100.667,00	1.100.667,00	907.483,00	82,45%
Materiale dhe inventari i vogël	423	280.000,00	280.000,00	226.834,00	81,01%
Riparimet dhe mirëmbajtja rrjedhëse	424	401.414,00	401.414,00	44.012,00	10,96%
Shërbime kontraktuese	425	640.000,00	640.000,00	588.977,00	92,03%
Shpenzime të tjera rrjedhëse	426	550.000,00	550.000,00	301.038,00	54,73%
Transferta të ndryshme	464	50.000,00	50.000,00	35.101,00	70,20%
Pagesa sipas dokumenteve ekzekutive	465	98.586,00	98.586,00	0	0,00%
Blerja e pajisjeve dhe makinave	480	1.004.881,00	1.004.881,00	779.881,00	77,61%
Blerja e mobileve	483	72.452,00	72.452,00	72.452,00	100,00%

Investime dhe mjete jo-financiare	485	100.000,00	100.000,00	32.450,00	32,45%
GJITHSEJ		18.238.000,00	17.529.138,00	16.040.194,00	87,95%

Anekse

- Aneksi 1: Pasqyra tabelare e rasteve të diskriminimit të konstatuar sipas fushave, llojeve dhe bazave të diskriminimit
- Aneksi 2: Raste të veçuara nga praktika
- Aneksi 3: Llogaria përfundimtare

Aneksi 1: Pasqyra tabelare e rasteve të konstatuara të diskriminimit sipas fushave, llojeve dhe bazave të diskriminimit

Fusha e diskriminimit	Lloji i diskriminimit	Bazat e diskriminimit	Numri i rasteve
Informimi publik dhe media	Ngacmimi	Seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia në një grup të marginalizuar dhe cilësia personale dhe statusi shoqëror	5
		Aftësia e kufizuar	1
		Identiteti gjinor dhe përkatësia në një grup të marginalizuar	1
		Orientimi seksual	1
		Orientimi seksual dhe identiteti gjinor	5
	Ngacmimi dhe thirrja, nxitja dhe instruksione për diskriminim	Përkatësia kombëtare ose etnike	3
		Seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia në një grup të marginalizuar dhe cilësia personale dhe statusi shoqëror	1
		Orientimi seksual dhe identiteti gjinor	2
	Ngacmimi në formën e diskriminimit të zgjatur	Seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia në një grup të marginalizuar dhe cilësia personale dhe statusi shoqëror	1
	Ngacmimi dhe thirrja e shumëfishtë, nxitja dhe instruksione për diskriminim	Seksi, gjinia, përkatësia në një grup të marginalizuar, statusi familjar ose martesor dhe orientimi seksual	1
	Ngacmimi i shumëfishtë dhe i zgjatur dhe ngacmimi seksual	Gjinia dhe përkatësia në një grup të marginalizuar	1
	Thirrja dhe nxitja për ngacmim	Orientimi seksual, identiteti gjinor dhe përkatësia në një grup të marginalizuar	1
	Thirrja, nxitja dhe instruksione për diskriminim	Seksi, gjinia dhe orientimi seksual	1
		Orientimi seksual	1
	Thirrja, nxitja dhe instruksione për diskriminim dhe ngacmim	Përkatësia kombëtare ose etnike dhe feja ose besimi fetar	1
		Orientimi seksual	1
Ngacmimi i përsëritura dhe i zgjatura	Seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia në një grup të marginalizuar dhe cilësia personale dhe statusi shoqëror	1	
Ngacmimi i zgjatura dhe i përsëritur	Seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor dhe përkatësia në një grup të marginalizuar	1	

		Seksi, orientimi seksual, identiteti gjinor, përkatësia në një grup të marginalizuar dhe cilësia personale dhe statusi shoqëror	1
	Ngacmimi i shumëfishtë dhe i zgjatur dhe nxitja për ngacmim	Përkatësia kombëtare ose etnike dhe përkatësia në një grup të marginalizuar	1
	Ngacmimi i zgjatura dhe i përsëritur	Përkatësia kombëtare ose etnike	1
	Rasti i thirrjes, nxitjes dhe instruksionit të zgjatur për diskriminim	Seksi, gjinia, orientimi seksual dhe identiteti gjinor	1
	Ngacmimi i zgjatur, i përsëritur dhe i shumëfishtë dhe thirrja, nxitja dhe instruksione për diskriminim	Orientimi seksual dhe përkatësia në një grup të marginalizuar	1
	Ngacmimi seksual	Seksi dhe gjinia	1
	Ngacmimi	Përkatësia kombëtare ose etnike dhe bindja politike	1
Arsimi, shkenca dhe sporti	Ngacmimi	Përkatësia kombëtare ose etnike dhe feja ose besimi fetar	1
	Diskriminimi direkt	Përkatësia kombëtare ose etnike	1
	Diskriminimi i përsëritur dhe i zgjatur direkt dhe diskriminimi indirekt	Cilësia personale dhe statusi shoqëror dhe mosha	1
	Diskriminimi indirekt me të cilin shkaktohet segregacion	Përkatësia kombëtare ose etnike	2
	Segregacioni dhe përjashtimi, diskriminimi i zgjatur direkt dhe thirrja, nxitja dhe instruksione për diskriminim	Aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore	1
Qasja në të mira dhe shërbime	Diskriminimi direkt	Përkatësia kombëtare ose etnike, përkatësia në një grup të marginalizuar, origjina sociale dhe statusi pronësor	1
		Përkatësia kombëtare ose etnike dhe feja ose besimi fetar	1
		Raca, ngjyra e lëkurës, përkatësia kombëtare ose etnike, përkatësia në një grup të marginalizuar dhe gjuha	1
		Raca, ngjyra, përkatësia kombëtare ose etnike, origjina sociale dhe statusi pronësor	1
		Origjina sociale dhe cilësia personale dhe statusi shoqëror	1
	U detektua diskriminim i shumëfishtë dhe i zgjatur direkt	Përkatësia kombëtare ose etnike, përkatësia në një grup të	1

		margjinalizuar, origjina sociale dhe statusi pronësor	
	Diskriminimi i zgjatur direkt	Aftësia e kufizuar	1
		Gjinia dhe përkatësia në një grup të marginalizuar	2
		Bazë tjetër: Vendi i shkollimit	1
Puna dhe marrëdhëniet e punës	Ngacmimi	Cilësia personale dhe statusi shoqëror	1
		Seksi dhe cilësia personale dhe statusi shoqëror	1
		Bindja politike	2
	Diskriminimi direkt	Cilësia personale dhe statusi shoqëror	5
		Bindja politike	1
		Aftësia e kufizuar	1
	Diskriminimi direkt dhe i zgjatur, ngacmimi në vendin e punës dhe viktimizimi	Bindja politike	1
Diskriminimi i zgjatur direkt	Arsimi	1	
Ngacmimi i zgjatur	Cilësia personale dhe statusi shoqëror	1	
Puna dhe marrëdhëniet e punës dhe Arsimi, shkenca dhe sporti	Diskriminimi direkt	Përkatësia kombëtare ose etnike dhe gjuha	1
Siguria sociale duke e përfshirë edhe fushën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe mbrojtjen shëndetësore	Diskriminimi i zgjatur direkt	Seksi	1
	Diskriminimi i zgjatur direkt ndërsektorial	Raca, përkatësia kombëtare ose etnike, seksi, përkatësia në një grup të marginalizuar, dhe origjina sociale	1
Anëtarësimi dhe aktivitetet në parti, shoqata të qytetarëve dhe fondacione sindikaliste ose organizata të tjera të bazuara në anëtarësimin dhe informimin publik dhe media	Ngacmimi i zgjatur dhe i shumëfishtë, thirrja e zgjatur dhe e shumëfishtë, nxitja dhe instruksione për ngacmim dhe diskriminimi direkt	Përkatësia kombëtare ose etnike, bindja tjetër dhe cilësia personale dhe statusi shoqëror	1
GJITHSEJ			70

Aneksi 2: Raste të veçuara nga praktika

Bursa për studentë/nxënës – diskriminimi indirekt në bazë të statusit arsimor dhe qasjes së pabarabartë në bursa më të larta në fushën e arsimit

Në verën e vitit 2021, Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpalli konkurse për ndarjen e bursave për studentë dhe për nxënësit e shkollave të mesme për vitin shkollor përkatësisht akademik 2021/2022, duke potencuar se Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka vendosur thuaja se ta dyfishojë shumën e bursave për përfituesit e rinj.

Komisionit iu parashtruan dy parashtrësra për mbrojtje nga diskriminimi nga një studente dhe nga një nxënës i shkollës së mesme, përfitues të bursave, të cilët të drejtën e realizuan para vitit akademik përkatësisht vitit shkollor 2021/2022 kurse kontratat e tyre në lidhje me bursat me automatizëm vazhduan të paguhen në një shumë më të ulët, megjithëse kushtet e përfitimit të kësaj të drejte ishin identike me dy konkurset e fundit të publikuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi në të dy rastet konstatoi diskriminim indirekt në bazë të statusit arsimor dhe shkeljes së të drejtës për trajtim të barabartë në përdorimin e bursave studentore/të nxënësve të shkollave të mesme, në një shumë më të lartë krahasuar me përfituesit e rinj, të kryer nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në fushën e arsimit.

Pas konstatimit të diskriminimit indirekt, KPMD-ja rekomandoi që Ministria e Arsimit dhe Shkencës të përpilojë ndryshime dhe plotësime të Programeve për realizimin e veprimtarive standardi studentor/i nxënësve të shkollave të mesme me një plan veprimi dhe implikimet përkatëse buxhetore, në mënyrë që të barazohen të gjitha bursat në 6050 ose 3500 denarë, në mënyrë adekuate dhe të njëjtat t'ia paraqesë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për miratim, në mënyrë që të eliminohet shkelja e konstatuar e së drejtës për barazi.

Gjatë miratimit të Buxhetit të RMV-së për vitin 2023, Kuvendi miratoi një amendament me të cilin u siguruan mjete për pagesën e rreth 3000 bursave studentore dhe rreth 1000 bursave për nxënësit e shkollave të mesme në shumë më të lartë, sipas rekomandimeve të KPMD-së.

Shoqata Qendra Kulturore Ivan Mihajlov Manastir – ngacmimi, nxitja dhe diskriminimi indirekt në bazë të përkatësisë kombëtare dhe etnike në fushën e shoqatave

OTh Lidhja e Luftëtarëve të LNÇ-së dhe Luftës Antifashiste të Maqedonisë 1941-45 dhe qytetarët përkrahës parashtruan parashtrësë për mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të përkatësisë kombëtare dhe etnike në fushën e veprimtarisë në shoqata dhe në organizata të tjera në bazë të anëtarësimit kundër Shoqatës Qendra Kulturore Ivan Mihajlov Manastir. Në këtë parashtrësë, ata theksojnë se anëtarët, familjet, mbështetësit dhe admiruesit e LNÇ-së dhe luftës antifashiste 1941-1945, pjesëtarë të popullit maqedonas dhe të të gjitha komuniteteve të tjera etnike në shoqërinë maqedonase, janë të shqetësuar dhe të fyer sa i përket dinjitetit dhe integritetit të tyre personal, për shkak të regjistrimit të shoqatës që mban emrin, siç thonë ata "të njërit prej eksponentëve më të mëdhenj të fashizmit... dhe bashkëpunëtor i Hitlerit, Musolinit,

Ante Paveliçit dhe Car Borisit të Tretë... me ç'rast bëhet promovimi dhe rehabilitimi i ideologjisë fashiste, militarizmit dhe politikave antimaqedonase..., promovohet revizionizmi historik" dhe mohohet identiteti kombëtar maqedonas.

Në saje të trajtimit të parashtrësës, në përputhje me kompetencat ligjore, Komisioni ndërmori një sërë veprimesh me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike. Shoqata u regjistrua më 15.03.2019 në Regjistrin Qendror në Manastir, ndërsa në dokumentacionin bashkëlidhur Komisioni konstatoi se në vend të pëlqimit - si akt administrativ - për përdorimin e emrit të një figure historike në emërtimin e shoqatës, Ministria e Drejtësisë lëshoi një njoftim ku thekson se meqë nuk posedon regjistër të figurave historike, nuk është në gjendje të lëshojë pëlqim. Për më tepër, Komisioni kërkoi edhe mendim profesional për emrin dhe veprën e Mihajlovit nga IPSH Instituti i Historisë Kombëtare, duke e pasur parasysh se në statutin, programin dhe faqen e internetit të shoqatës në rrjetin social "Facebook" në mënyrë të qartë theksohet se detyra dhe qëllimi kryesor i shoqatës është promovimi i jetës, ideologjisë, rehabilitimi dhe ndriçimi e figurës dhe veprës së Ivan Mihajlov-it. IHK e adresoi opinionin profesional në të cilin specifikoi se "Emërimi i ndonjë qendre, klubi apo shoqate të qytetarëve me emrin Ivan Mihajlov është provokim i pashembullt dhe fyerje për popullin maqedonas, sepse duke propaganduar figurën dhe veprën e tij, në fakt, propagandohet... bashkëpunimi i tij me ideologjinë fashiste dhe naziste, si dhe mohimi nga ana e tij, prej shtatë dekadash, të popullit maqedonas".

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi në këtë rast konstatoi ngacmim të zgjatur dhe të shumëfishtë si një lloj diskriminimi më i rëndë në bazë të përkatësisë kombëtare dhe etnike, të kryer nga Shoqata Qendra Kulturore Ivan Mihajlov ndaj anëtarëve, familjeve, mbështetësve dhe admiruesve të Lidhjes së Luftëtarëve të LNÇ-së, ndaj popullit maqedonas dhe pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve etnike në shoqërinë maqedonase. Përveç kësaj, Komisioni konstatoi thirrje, nxitje dhe instruksion për diskriminim të zgjatur dhe të shumëfishtë si një lloj diskriminimi më i rëndë në bazë të përkatësisë kombëtare dhe etnike, të kryer nga Shoqata Qendra Kulturore përmes publikimit të përmbajtjeve ngacmuese që e promovojnë figurën dhe ideologjinë e Ivan Mihajlov-it përmes faqes së tyre në rrjetin social "Facebook".

Komisioni mes tjerash konstatoi edhe diskriminim indirekt të kryer nga Ministria e Drejtësisë për mos ushtrimin e kompetencave të saj ligjore me ç'rast i mundësuan Shoqatës Qendra Kulturore t'i kryejë veprimet e lartpërmendura shqetësuese, në drejtim të mundësimin të abuzimit të lirisë së asociimit dhe tubimit që rezultoi me llojet e theksuara të diskriminimit.

Pas llojeve të konstatuara të diskriminimit, Komisioni i rekomandoi Shoqatës Qendra Kulturore Ivan Mihajlov që t'i largojë të gjitha elementet kontestuese sa i përket emrit, statutit dhe programit të punës që shkaktonin ngacmime, brenda 45 ditëve, si dhe ti heqë të gjitha përmbajtjet kontestuese ngacmuese nga faqja e tyre në Facebook sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë.

Komisioni i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me nenin 58, të bëjë mbikëqyrje mbi ligjshmërinë e zbatimit të Ligjit për shoqata dhe fondacione, veçanërisht në pjesën e akteve të Shoqatës në lidhje me nenin 4 të LShF-së, duke marrë parasysh nenin 20 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut brenda afatit prej 45 ditëve.

Pas pranimit të njoftimeve me shkrim nga Shoqata dhe Ministria e Drejtësisë se nuk i kanë zbatuar rekomandimet e KPMD-së, konform kompetencave ligjore, Komisioni paraqiti kërkesë për iniciimin e

procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente për kundërvajtje kundër Kryetarit të Shoqatës dhe kundër Ministrit të Drejtësisë.

E. Nga Gostivari – segregacioni dhe përjashtimi, diskriminim i zgjatur direkt në bazë të aftësisë së kufizuar dhe nevojave të veçanta arsimore dhe thirrjes, nxitjes dhe instruksionit për diskriminim në fushën e arsimit inkluziv

Pas pranimit të informacioneve përmes mediave që përmbanin indikacione për segregacion të mundshëm ndaj një nxënëse me nevoja të veçanta arsimore në një shkollë fillore në Gostivar, Komisioni mori vendim të iniciojë procedurë për mbrojtjen nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare. Me fjalë të tjera, informacionet vunë në dukje se pas një peticioni të nënshkruar nga prindërit e shokëve të klasës së nxënëses, ajo dhe asistentja e saj arsimore u transferuan në një hapësirë joadekuate pa ngrohje adekuate për ta zhvilluar procesin arsimor, në kundërshtim me parimet e Konventës për Arsim Inkluziv.

Duke e trajtuar lëndën, Komisioni realizoi një takim me kryetarin e komunës dhe me përfaqësuesit e pushtetit komunal, si themelues të shkollës, të cilët organizuan një takim të përbashkët me prindërit nënshkruar të peticionit, si dhe me të gjithë përfaqësuesit profesionistë të shkollës, të përfshirë në ekipin gjithëpërfshirës të shkollës. Në mënyrë plotësuese, KPMD-ja realizoi takime të drejtpërdrejta dhe të tërthorta me Qendrën Rajonale të Resurseve “Dr. Zlatan Sremac” Shkup si dhe me përfaqësuesit e Organit Profesional Rajonal për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit Funkcional – Shkup, nga ku morën njohuri dhe dokumente shtesë në lidhje me rastin. Komisioni bëri edhe një këqyrje të drejtpërdrejtë të hapësirës shkollore ku nxënësja u dislokua që ta ndjekë procesin mësimor me asistenten e saj personale arsimore, ndërsa për kontroll i pranoi edhe raportet javore nga asistentja të cilat ia ka dërguar Qendrës së Resurseve për rrjedhën e procesit arsimor të nxënëses.

Sipas asaj që u tha më lartë, Komisioni konstatoi segregacion dhe përjashtim në bazë të aftësisë së kufizuar të ushtruar nga shkolla fillore, të realizuar përmes ndarjes fizike të pajustifikuar dhe të paligjshme të nxënëses të diskriminuar nga shokët e tjerë të klasës pa aftësi të kufizuara, gjë që rezultoi me përjashtim, përkatësisht me pamundësimin e të drejtës së saj për qasje në procesin arsimor inkluziv. Komisioni konstatoi edhe diskriminim të zgjatur direkt nga ana e shkollës, të kryer nga mospërshtatja e infrastrukturës shkollore në kuptimin e sigurimit të një hapësire me ndjeshmëri të resurseve të pajisur me teknologji të përshtatshme asistive, gjë që rezultoi me pamundësimin e qasjes në arsim në bazë të barabartë me të tjerët mbi bazë të aftësisë së kufizuar dhe nevojave të veçanta arsimore të nxënëses.

Përveç kësaj, Komisioni konfirmoi thirrje, inkurajim dhe udhëzim për diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes shëndetësore të ushtruar nga njëmbëdhjetë prindërit e shokëve të klasës së nxënëses duke nënshkruar një peticion për të hequr nxënësen nga shkollimi i rregullt dhe bojkotim të procesit mësimor, duke mos i lënë fëmijët e tyre të shkojnë në shkollë derisa të plotësohen kërkesat e tyre, duke rezultuar në segregacion në bazë të aftësisë së kufizuar dhe nevojave të veçanta arsimore.

Për të eliminuar të gjitha shkeljet e konstatuara më sipër lidhur me të drejtën e barazisë, Komisioni i rekomandoi shkollës fillore të sigurojë kushte për zhvillimin pa pengesa të procesit mësimor të nxënëses në

të njëjtën klasë me shokët e saj të klasës dhe të parandalojë çdo formë të përjashtimit dhe segregacionit të nxënës nga procesi edukativo arsimor. Së këtejmi, Komisioni e ngarkoi shkollën, përkatësisht ekipin individual dhe inkluziv shkollor të nxënës, me mbështetjen e Qendrës Rajonale të Resurseve, të sigurojnë një program mësimor të modifikuar dhe efektiv për nxënësen me nevoja të veçanta arsimore. Në mënyrë plotësuese, shkolla u ngarkua të përpilojë një plan veprim, të aprovuar nga Qendra e Resurseve, në të cilin në mënyrë të detajuar do të përcaktohen masat, aktivitetet dhe afatet në të cilat u siguroa një hapësirë përkatëse me ndjeshmëri të resurseve të pajisur me teknologji asistive të përshtatur për nevojat e nxënës.

Komisioni rekomandoi që shkolla t'i kërkojë Qendrës së Resurseve të realizojë trajnim të detyrueshëm me mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionistë të cilët janë përfshirë drejtpërdrejt në punën edukative arsimore të nxënës në lidhje me parimet inkluzive dhe mënyrën e përdorimit të teknologjisë asistive për nevojat specifike arsimore të saj.

Në fund, Komisioni rekomandoi që drejtori i shkollës, në përputhje me kompetencat ligjore dhe në bashkëpunim me ekipin inkluziv shkollor, të organizojë një takim me prindërit e nënshkruar të peticionit për largimin e nxënës nga procesi i rregullt mësimor, në të cilin do tua vënë në dukje parimet dhe implementimin e detyrueshëm të Konceptit të Arsimit Inkluziv dhe ndalimin ligjor për të bërë thirrje, nxitje dhe instruksione për diskriminim, me prezencë të detyrueshme të secilit prind, duke ua bërë me dije se të gjitha veprimet e tilla i nënshtrohen përgjegjësisë për kundërvajtje, konform ligjit.

Brenda afateve të parashikuara, Komisioni u informua me shkrim se të gjitha rekomandimet u përmbushën në mënyrë adekuate.

T.D.- diskriminimi i zgjatur direkt, ngacmimi dhe viktimizimi në bazë të bindjes politike në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës

Parashtruesja e parashtresës, si punonjëse e administratës në një komunë më të madhe, deklaroi se pas përfundimit të zgjedhjeve lokale në vitin 2021, ajo u urdhërua të largohej menjëherë nga vendi i punës dhe të kryente detyra pune në ambientet e komunës rreth një kilometër larg ndërtesës së komunës. Kur ajo e pyeti kryetarin e komunës pse vetëm ajo nga të gjithë kolegët e tjerë u urdhërua të kryejë punë të këtilla, ai i tha hapur se kishte presion nga partia e tij, sepse burri i saj qenka i angazhuar për një opion tjetër politik gjatë fushatës, me ç'rast ajo i tha hapur se refuzon ta kryejë urdhrin, sepse në ambientet e reja nuk paska kushte për të kryer detyrat e punës. Parashtruesja ndjeu ngacmim dhe vizitoi një mjek specialist, i cili lëshoi një mendim mjekësor se ajo ka manifestuar reagime psikosomatike si rezultat i ngjarjeve në vendin e punës dhe i ka përshkruar terapi përkatëse. Mbas pretendimeve të këtilla, Komisioni kërkoi nga kryetari i komunës të prononcohet për pretendimet e parashtresës, duke ia kaluar barrën e provës atij në lidhje me pretendimet për diskriminim për sa i përket bindjes politike.

Meqë gjatë prononcimit kryetari i komunës nuk ofroi asnjë kundër argument ndaj pohimeve të parashtrueses, se bëhet fjalë për diskriminim me motive politike, Komisioni bëri disa inspektime të drejtpërdrejta në vendin e ngjarjes në komunë në mënyrë që ta përcaktojë gjendjen faktike, me ç'rast grumbulloi dhe dokumentoi një sërë provash, dhe rrjedhimisht me këtë miratoi një Opinion me të cilin

konstatoi diskriminim të zgjatur direkt në bazë të bindjes politike të kryer nga kryetari i komunës, në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës.

Përveç kësaj, Komisioni konstatoi edhe ngacmim në vendin e punës në bazë të bindjes politike nga kryetari i komunës ndaj parashtrueses, si dhe viktimizimin si formë diskriminimi që nënkupton vuajtje të pasojave të dëmshme të personit, i cili ka ndërmarrë veprime për mbrojtje nga diskriminimi, të kryer ndaj parashtrueses nga sekretari i komunës, kur e ndëshkoi me dënim monetar për shkelje disiplinore që ka ndodhur disa vjet më parë dhe konform ligjit, lënda është parashkruar.

Pas diskriminimit të konstatuar, Komisioni rekomandoi që kryetari i komunës të miratojë një akt administrativ me të cilin do ta anulojë urdhrin për dislokimin e parashtrueses në ambientet e reja, si dhe të sigurojë parashtrueses punë dhe detyra pune në përputhje me aktvendimin për sistematizimin e vendit të punës. Komisioni i rekomandoi kryetarit të komunës të nënshkruajë një Prokurë në mënyrë që të mund t'i kryejë detyrat specifike të punës që janë në përshkrimin dhe inventarin e aktit të sistematizimit, si dhe ta ndërpresë ngacmimin ndaj parashtrueses gjë e cila rezultoi nga cenimin e dinjitetit të saj personal dhe shkaktoi ndjenjë kërcënimi ndaj vendit të saj të punës, ndërsa e ka bërë në bazë të bindjes së saj politike.

Komisioni, mes tjerash, dërgoi një rekomandim deri te sekretari i komunës që të nxjerrë një akt administrativ me të cilin do ta anulojë vendimin për shqiptimin e masës disiplinore ndaj parashtrueses për një vepër tani më të parashkruar, sepse e njëjta paraqet viktimizim si një formë e veçantë e diskriminimit.

Për këtë rast, në rrjedhë e sipër është iniciimi i procedurës për kundërvajtje kundër autorëve të diskriminimit para gjykatës kompetente për kundërvajtje.

Diskriminim i zgjatur direkt në bazë të aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të marginalizuar në fushën e qasjes në të mira dhe shërbime

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi inicioi procedurë për mbrojtjen nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare pasi që mediat raportuan se një person me aftësi të kufizuara fizike në karrocë invaliditeti përdor ndihmë asistive nga një qen -shoqërues i trajnuar dhe i njëjti disa herë nuk u lejua të përdorte transportin publik me arsyetimin se qeni nuk kishte maskë mbrojtëse.

Komisioni ndërmori një sërë aktivitete dhe bëri inspektime të drejtpërdrejta në ambientet e NTP "Shkupi", me ç'rast konstatoi se në këtë rast ekziston diskriminim i zgjatur direkt në bazë të aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një grup të marginalizuar në fushën e qasjes në të mira dhe shërbime, të kryer nga NTP "Shkupi" nga Shkupi dhe u rekomandoi autoriteteve udhëheqëse të hartojnë një propozim-vendim me të cilin personave me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara do t'ju lejohet t'i përdorin shërbimet e kësaj ndërmarrjeje publike të shoqëruar nga qentë e tyre, të cilët janë të trajnuar të ofrojnë mbështetje asistive për këta persona dhe të njëjtin ta publikojnë në faqen e tyre të internetit në mënyrë që ta informojnë publikun dhe të gjithë punonjësit në institucionin e tyre se e drejta e qasjes në të mira dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara, të cilët përdorin forma të ndryshme të ndihmës asistive, duhet të realizohet në bazë të barabartë me personat e tjerë. Komisioni rekomandoi që NTP "Shkupi" Shkup të përgatisë etiketa përkatëse dhe lehtësisht të dallueshme për shënimin e autobusëve dhe automjeteve,

përmes të cilave qytetarët do të njoftohen se transporti i personave me aftësi të kufizuara të shoqëruar me qen për mbështetje asistive është i lejuar, pa e pasur detyrimin të mbajnë maska mbrojtëse.

Brenda afatit të përcaktuar ligjor, Komisioni konstatoi se NTP "Shkupi" i zbatoi plotësisht rekomandimet, me ç'rast u eliminua cenimi i së drejtës së qasjes së barabartë në të mira dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara.

U konstatua ngacmim ndaj personave me aftësi të kufizuara nga drejtori i Qendrës për Menaxhimin me Kriza

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi ngacmim në bazë të aftësisë së kufizuar ndaj personave me aftësi të kufizuara, të kryer nga drejtori i Qendrës për Menaxhimin me Kriza, Stojançe Angelov, në fushën e medias dhe informimit publik.

Pas reagimit të disa shoqatave të qytetarëve sa i përket deklaratës shqetësuese të Angelovit në lidhje me personat me aftësi të kufizuara në emisionin "Fli nëse mundesh" në TV Alfa, Komisioni inicioi procedurë sipas detyrës zyrtare. Në emisionin e lartpërmendur, Angelovi në pyetjen e parashtruar nga drejtuesi i emisionit a do të pranonte të ballafaqohet në një emision debativ me personin Blagojço Georgiev (një person që përdor karrocë invaliditeti), ndër të tjera, Angelov u përgjigj: "Unë si të them si të dal me të në debat? _Nesër mund ti kujtohet edhe dikujt tjetër. Mbas nesër ndonjë personi të tretë. **Si e para do të ndihem i ndotur të debatoj me një njeri në karrocë invaliditeti.**"

Duke e pasur parasysh se deklarata në fjalë është bërë nga një person i emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili është duke e ushtruar detyrën e Drejtorit të Qendrës për Menaxhimin e Kriza, në një emision televiziv që transmetohet në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe mbulon një numër më të madh të personave, ndërsa emisioni është akoma i aksesshëm dhe vazhdimisht mund të shkaktojë ngacmim të zgjatur në bazë të aftësisë së kufizuar tek personat me aftësi të kufizuara, Komisioni vendosi sipas detyrës zyrtare të iniciojë procedurë për mbrojtjen nga diskriminimi kundër Stojançe Angelov-it për ngacmimin e kryer potencial në bazë të aftësisë së kufizuar ndaj personave me aftësi të kufizuara në fushën e medias.

Pas procedurës së zbatuar, Komisioni konstatoi ngacmim nga Angelovi ndaj personave me aftësi të kufizuara në bazë të aftësisë së kufizuar në fushën e medias dhe njoftimit publik.

Praktika e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) përcakton se liria e fjalës përfundon aty ku fillojnë të cenohen të drejtat e të tjerëve. Me fjalë të tjera, në rastin e Seurot v Frnace, GJEDNJ konstatoi se ***pa dyshim çdo veprim i drejtuar kundër vlerave themelore të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut do të shmanget nga mbrojtja e nenit 10 të Konventës (liria e shprehjes) dhe do t'i nënshtrohet nenit 17 të Konventës (ndalohet abuzimi i të drejtave).***

Në rastin Erbakan kundër Turqisë, GJEDNJ konstatoi se toleranca dhe respekti i dinjitetit në mënyrë të barabartë për të gjithë njerëzit i përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike, pluraliste. Duke e pasur parasysh këtë që u tha më lartë, parimisht mund të konsiderohet se në disa shoqëri demokratike nevojitet të sanksionohen ose madje të parandalohen të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë intolerancë ose urrejtje.

Neni 19 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, nënshkruar i të cilit është edhe Republika e Maqedonisë së Veriut, e garanton të drejtën e mendimit dhe lirinë e shprehjes pa asnjë ndërhyrje. Megjithatë, paragrafi 3 i këtij neni përcakton se ***gëzimi i kësaj të drejte i nënshtrohet detyrimeve dhe detyrave të veçanta, dhe për këtë arsye mund të kufizohet me ligj, kur një gjë e këtillë është e nevojshme për respektimin e të drejtave të të tjerëve.***

Neni 6 i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, nënshkruar i së cilës është edhe Republika e Maqedonisë së Veriut, përcakton se ***shtetet palë do të ndalojnë çdo diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar dhe do t' u garantojnë personave me aftësi të kufizuara mbrojtje të barabartë dhe efektive ligjore nga diskriminimi mbi të gjitha bazat.*** Neni 8 i Konventës, ndër të tjera, përcakton detyrimin për shtetet palë që të marrin masa të drejtpërdrejta, efektive dhe adekuate për të parandaluar stereotipat, paragjykimet dhe praktikat e dëmshme ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe për të inkurajuar të gjitha mediat që t' i pasqyrojnë personat me aftësi të kufizuara në përputhje me qëllimet e kësaj Konvente.

Neni 21 i Kartës së të Drejtave Fundamentale të Bashkimit Evropian përcakton se çdo diskriminim mbi çfarëdo lloj baze siç është seksi, raca, ngjyra, origjina etnike ose sociale, tiparet gjenetike, gjuha, feja ose besimi, mendimi politik ose ndonjë mendim tjetër, përkatësia në një pakicë kombëtare, prona, lindja, aftësia e kufizuar, mosha ose orientimi seksual do të ndalohen.

Komisioni gjatë miratimit të opinionit e vlerësoi faktin se Angelov u emërua nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut si drejtor i një autoriteti të pavarur të administratës shtetërore – Qendra për Menaxhim me Kriza, përkatësisht ushtron funksion publik, dhe si i tillë ka një përgjegjësi akoma më të madhe në paraqitjet e tij publike të përmbahet nga përhapja e gjuhës ngacmuese dhe diskriminuese mbi çfarëdo lloj baze.

Në opinionin e miratuar, Komisioni rekomandoi që Angelovi t' u kërkojë falje publike personave me aftësi të kufizuara për deklaratën e tij, më së voni 30 ditë nga dita e pranimit të opinionit, dhe për këtë ta njoftojë Komisionin, ndërsa faljen publike Angelovi t' ia dërgojë TV Alfa. Gjithashtu, Stojançe Angelovit i rekomandohet që në të ardhmen, në paraqitjet e tij publike, të përmbahet nga deklaratat ngacmuese të cilat bëjnë thirrje, nxisin dhe kanë insinuata diskriminuese mbi çfarëdo lloj baze.

Pas pranimit të opinionit të miratuar, Angelovi e informoi Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, se brenda afatit të caktuar kohor ai veprroi në bazë të rekomandimit dhe se Televizionit Alfa i dërgoi falje publike për personat me aftësi të kufizuara.

Zyrat e kontaktit të qytetarëve me deputetët në Komunën e Karposhit të paakseshme për personat me aftësi të kufizuara

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi diskriminimin të zgatur direkt në bazë të aftësisë së kufizuar në fushën e qasjes në të mira dhe shërbime nga Komuna e Karposhit ndaj personave me aftësi të kufizuara fizike – banorë të Komunës së Karposhit.

Pas njoftimit nga ueb portali portalb.mk, Komisioni pranoi një njoftim se dy zyra kontakti të qytetarëve me deputetët e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Komunën e Karposhit, janë vendosur në mbikalimin "Vlajko" ku ashensorët dhe shkallët elektrike nuk janë në funksion, me ç'rast personave me aftësi të kufizuara u pamundësohet qasja.

Duke e marrë parasysh se njoftimi bazohet në faktin se nga autoritetet shtetërore, autoritetet e njëjshme të vetëqeverisjes lokale, personat juridikë me autorizime publike është kryer diskriminim në përputhje me bazat diskriminuese, si dhe fakti se në këtë rast është përfshirë një numër më i madh i personave, Komisioni vendosi të iniciojë procedurë sipas detyrës zyrtare kundër Komunës së Karposhit për diskriminim potencial në bazë të aftësisë së kufizuar sa i përket qasjes në të mira dhe shërbime.

Mbas procedurës së zbatuar, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatoi se me mospërshtatjen e zyrave të kontaktit të qytetarëve me deputetët, diskriminim i zgatur direkt ndaj personave me aftësi të kufizuara fizike u krye nga Komuna e Karposhit.

Përkatësisht, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë i gëzojnë liritë dhe të drejtat e tyre.

Republika e Maqedonisë së Veriut në vitin 2011 e ratifikoi **Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara**, e cila ka për qëllim promovimin, mbrojtjen dhe sigurimin e gëzimit të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, ndërkaq Konventa në përputhje me nenin 118 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut është pjesë e rendit të brendshëm juridik.

Në këtë drejtim, në nenin 2 të Konventës, përshtatja adekuate përcaktohet si "modifikim dhe rregullim i nevojshëm dhe adekuat, duke mos imponuar një barrë joproporcionale ose joadekuate, nëse është e nevojshme në një rast të caktuar, për t'ua siguruar personave me aftësi të kufizuara t'i gëzojnë ose realizojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në bazë të barabartë me të tjerët". Së këtejmi, shtetet palë kontraktuese ngarkohen t'i ndërmarrin të gjitha hapat e duhur për të siguruar përshtatje adekuate.

Nga ana tjetër, në nenin 9 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përcaktohet një detyrim për shtetin që të ndërmarrë masa të duhura në mënyrë që t'u mundësojë personave me aftësi të kufizuara të jetojnë të pavarur dhe përgjithësisht të marrin pjesë në të gjitha aspektet e jetës. Në këtë kontekst, duhet të sigurohet, në mënyrë të barabartë me të tjerët, qasja në mjedisin fizik, transportin, informacionet dhe komunikimet, duke përfshirë teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në kapacitete dhe shërbime të tjera transparente ose të siguruar për publikun, në zonat urbane dhe rurale.

Neni 29 i Konventës parashikon të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të marrë pjesë në jetën politike dhe publike në bazë të barabartë me të tjerët.

Në këtë kontekst, përshtatja adekuata përcaktohet edhe në nenin 4, paragrafi 4 të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Përshtatja adekuata është ndryshim dhe përshtatje e domosdoshme dhe adekuata e nevojshme në një rast të caktuar, që nuk shkakton barrë disproporcionale ose të panevojshme, me qëllim të sigurimit të gëzimit ose realizimit të të gjitha të drejtave dhe lirive të personave me aftësi të kufizuara, mbi bazë të barabartë me të tjerët. Pamundësimi i përshtatjes adekuata është diskriminim.

Në nenin 4, paragrafin 5, Ligji e përcakton qasjen në infrastrukturë, në të mira dhe shërbime:

Qasja në infrastrukturë, në të mira dhe shërbime nënkupton ndërmarrje të masave përkatëse që sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara kanë qasje, në bazë të barabartë me të tjerët, në mjedisin fizik, transportin, informacionet dhe komunikimin, duke i përfshirë teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, në objekte dhe shërbime të tjera publike në zonat urbane dhe rurale. Pamundësimi i qasjes dhe arritshmërisë në infrastrukturë, në të mirat dhe shërbimet është diskriminim. "

Rrjedhimisht, Komisioni konstatoi diskriminim të zgjatur direkt dhe i rekomandoi Komunës së Karposhit në afat prej 30 ditëve nga pranimi i opinionit ta hartojë planin e veprimit me specififikimin e aktiviteteve, afatet kohore dhe implikimet financiare për të siguruar përshtatshmërinë e duhur, që do të mundësojë qasje për personat me aftësi të kufizuara në zyrat e kontaktit të qytetarëve me deputetët dhe për këtë ta njoftojë Komisionin. Njëherësh Komunës iu rekomandua që brenda 180 ditëve nga pranimi i opinionit ti kryejë të gjitha masat dhe aktivitetet e nevojshme për ta siguruar përshtatjen e duhur që do të mundësojë qasje të personave me aftësi të kufizuara në zyrat e kontaktit të qytetarëve me deputetët dhe për këtë ta informojë Komisionin.

Segregacioni i fëmijëve romë në arsimin fillor

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi veprroi në dy lëndë lidhur me segregacionin si formë diskriminimi që për sinonim i kishte fëmijët e përkatësisë etnike rome në arsimin fillor. Në të dyja lëndët, Komisioni konstatoi diskriminim indirekt me të cilin shkaktohet segregacion në bazë të përkatësisë etnike në fushën e arsimit që rezulton nga dispozitat e Ligjit për arsimin fillor³. Për më tepër, Komisioni konstatoi se Ligji për arsimin fillor, në përputhje me nenin 63, ua mundëson prindërve t'i regjistrojnë fëmijët e tyre brenda dhe jashtë zonës ku ata jetojnë. Kjo zgjidhje ligjore krijon një situatë në të cilën prindërit, meqë nuk duan fëmijët e tyre të mësojnë në një shkollë ku shumica e fëmijëve janë të përkatësisë etnike rome, kanë dy mundësi për t'i regjistruar fëmijët e tyre në shkolla me nxënës të përkatësisë etnike maqedonase, ndërkaq janë jashtë zonës ku jetojnë këta prindër. Të dyja rastet janë regjistruan në dy shkolla fillore në qytetin e Shtipit dhe Manastirit. Në mënyrë plotësuese, Gjykata e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, më 13 dhjetor 2022, në aktgjykimin Elmazova dhe të tjerë kundër Maqedonisë së Veriut⁴,

³Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr 161/2019 datë 05.08.2019; 229/2020 datë 23.09.2020

⁴[https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid": "\[\" 001-221503 \"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

konstatoi se ekziston segregacion në kuadër të shembujve të lartpërmendur gjatë paraqitjes së padive nga prindërit, fëmijët e të cilëve mësojnë në shkollat në Shtip dhe Manastir. Në aktgjykim, Gjykata i citon argumentet dhe faktet e përfshira në opinionet e miratuara nga Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga përkufizimi dhe problemi shoqëror i përshkruar më sipër, konfirmohet se prindërit nuk kanë një qëllim legjitim dhe objektivist të justifikuar që t'i regjistrojnë fëmijët e tyre jashtë rajoneve ku ata jetojnë. Përbërja etnike e fëmijëve në shkolla të ndryshme në të gjithë vendin e vë në dukje faktin se nuk bëhet fjalë për raste individuale tek prindërit, por për ndarje të vetëdijshme të fëmijëve të tyre nga fëmijët me përkatësi etnike rome (me numrin e fëmijëve të regjistruar në klasën e parë dhe atë se që të gjithë janë romë, konfirmoni këtë). Një kontekst i këtillë mund të lërë pasojë të thella jo vetëm ndaj fëmijëve të përkatësisë etnike rome, por edhe ndaj fëmijëve jo-romë, sepse mungesa e mundësive dhe rasteve për fëmijët me prejardhje të ndryshme kulturore dhe etnike për t'u integruar dhe mësuar për njëri-tjetrin, në të ardhmen mund të çojë në intolerancë dhe diskriminim nga "grupi më i fortë përkatësisht me numër më të madh".

Aneksi 3: Llogaria përfundimtare

Период

Контролор

Вид, раб

Идентификационен број

Резервни кодекси

Назив на субјектот

- Комисија за спречување и заштита од дискриминација

Адреса, седиште и телефон

- Даме Груев Бр.1 Скопје

Единствен даночен број

- 4080021595665

(корисници на средства од Буџетот)

ПРИХОДИ И РАСХОДИ

во текот на годината - Биланс на приходите и расходите
од 01.01.2022 до 31.12.2022 година

1	2	ПОЗИЦИЈА 3	Ознака на АОП 4	Износ	
				Претходна година 5	Тековна година 6
		I. ТЕКОВНИ РАСХОДИ	001	8.084.513	15.155.411
		а) ПЛАТИ И НАДОМЕСТОЦИ	002	6.938.614	12.481.138
1	401	Плати и надоместоци	003	4.958.608	8.918.032
2	402	Придонеси за социјално осигурување	004	1.926.006	3.464.106
3	403	Останати придонеси од плати	005		
4	404	Надоместоци	006	54.000	99.000
		б) РЕЗЕРВИ И НЕДЕФИНИРАНИ РАСХОДИ (од 008	007	0	0
5	411	Финансирање на нови програми и потпрограми	008		
6	412	Постојана резерва (непредвидливи расходи)	009		
7	413	Тековни резерви (разновидни расходи)	010		
8	414	Резерви за капитални расходи	011		
		в) СТОКИ И УСЛУГИ	012	1.145.899	2.639.172
9	420	Патни и дневни расходи	013	15.881	570.828
10	421	Комунални услуги, греење, комуникација и	014	309.069	907.483
11	423	Материјали и ситен инвентар	015	211.174	226.834
12	424	Поправки и тековно одржување	016	284.784	44.012
13	425	Договорни услуги	017	142.800	588.977
14	426	Други тековни расходи	018	182.191	301.038
15	427	Привремени вработувања	019	0	0

1	2	ПОЗИЦИЈА 3	Ознака на АОП 4	Износ	
				Претходна година 5	Тековна година 6
		г) ТЕКОВНИ ТРАНСФЕРИ ДО ВОНБУЏЕТСКИ	020	0	0
16	431	Трансфери до Фондот за ПИОМ	021		
17	432	Трансфери до Агенцијата за вработување	022		
18	433	Трансфери до Фондот за здравствено	023		
		д) ТЕКОВНИ ТРАНСФЕРИ ДО ЕЛС	024	0	0
19	441	Дотации од ДДВ	025		
20	442	Наменски дотации	026		
21	443	Блок дотации	027		
22	444	Дотации за делегирани одделни надлежности	028		
		ѓ) КАМАТНИ ПЛАЌАЊА	029	0	0
23	451	Каматни плаќања кон нерезидентни кредитори	030		
24	452	Каматни плаќања кон домашни кредитори	031		
25	453	Каматни плаќања кон други нивоа на власт	032		
		е) СУБВЕНЦИИ И ТРАНСФЕРИ (од	033	0	35.101

26	461	Субвенции за јавни претпријатија	034		
27	462	Субвенции за приватни претпријатија	035		
28	463	Трансфери до невладини организации	036		
29	464	Разни трансфери	037	0	35.101
30	465	Ислати по извршни исправи	038		
		ж) СОЦИЈАЛНИ БЕНЕФИЦИИ (од	039	0	0
31	471	Социјални надоместоци	040		
32	472	Плаќања на бенефиции од Фондот за ПИОМ	041		
33	473	Плаќање на надоместоци од Агенцијата за	042		
34	474	Плаќање на надоместоци од Фондот за	043		
		II. КАПИТАЛНИ РАСХОДИ	044	1.707.801	884.783
35	480	Купување на опрема и машини	045	1.053.385	779.881
36	481	Градежни објекти	046		
37	482	Други градежни објекти	047		
38	483	Купување на мебел	048	591.416	72.452
39	484	Стратешки стоки и други резерви	049		
40	485	Вложувања и нефинансиски средства	050	63.000	32.450
41	486	Купување на возила	051		
42	487	Капитални трансфери	052		
43	488	Капитални дотации до ЕЛС	053		
44	489	Капитални субвенции за претпријатија и	054		

1	2	ПОЗИЦИЈА 3	Ознака на АОП 4	И з н о с	
				Претходна година 5	Тековна година 6
		III. ОТПЛАТА НА ГЛАВНИНА (од 056 до 058)	055	0	0
45	491	Отплата на главнина до нерезидентни	056		
46	492	Отплата на главнина кон домашни институции	057		
47	493	Отплата на главнина до други нивоа на власт	058		
		А. ВКУПНО РАСХОДИ	059	9.792.314	16.040.194
		Б. ОСТВАРЕН ВИШОК НА ПРИХОДИ-ДОБИВКА	060	0	0
48	811,812	В. ДАНОЦИ, ПРИДОНЕСИ И ДРУГИ	061		
		Г. НЕТО ВИШОК НА ПРИХОДИ-ДОБИВКА ПО	062	0	0
		Д. РАСПОРЕДУВАЊЕ НА НЕТО ВИШОКОТ НА	063	0	0
49	830	За покривање на загуба	064		
50	831	За поврат во буџетот односно фондот	065		
51	833	За пренос во наредната година	066		
		Г. ВКУПНО	067	9.792.314	16.040.194
		П Р И Х О Д И:	068	0	0
52	711	Данок од доход, од добивка и од капитални	069		
53	712	Придонеси за социјално осигурување	070		
54	713	Даноци од имот	071		
55	714	Домашни даноци на стоки и услуги	072		
56	715	Данок од меѓународна трговија и трансакции	073		
57	716	Еднократни посебни такси	074		
58	717	Даноци на специфични услуги	075		
59	718	Такси за користење или дозволи за	076		
		II. НЕДАНОЧНИ ПРИХОДИ	077	0	0
60	721	Претприемачки приход и приход од имот	078		
61	722	Глоби, судски и административни такси	079		
62	723	Такси и надоместоци	080		
63	724	Други владини услуги	081		
64	725	Други неданочни приходи	082		

1	2	ПОЗИЦИЈА 3	Ознака на АОП 4	И з н о с	
				Претходна година 5	Тековна година 6
		III. КАПИТАЛНИ ПРИХОДИ	083	0	0
65	731	Продажба на капитални средства	084		
66	732	Продажба на стоки	085		
67	733	Продажба на земјиште и нематеријални	086		

Период

Контролор

510 07463783
4 5 6 7 8 9 10 11

0201162944
12 13 14 15 16 17 18 19 20 21 22 23 24 25 26

Вид раб - Идентификационен број
 Назив на субјект - Колекција за спречување и заштита од дискриминација
 Адреса, седиште и телефон - Даме Груев бр.1 Скопје 0 2323 2368
 Единствен даночен број - 4080021595665

Резервни поднески

БИЛАНС НА СОСТОЈБА
 на ден 31.12.2022 година
 (во денари)

Ред.бр	Група на сметки, или сметка	ПОЗИЦИЈА	Ознака на АОП	Износ			Нето (6 - 7)
				Претходна состојба (почетна состојба)	Бруто	Исправка на вредноста	
1	2	3	4	5	6	7	8
1	0	A) АКТИВА: ПОСТОЈАНИ СРЕДСТВА (112+113+114+122+123)	111	1.781.154,00	2.766.575,00	586.858,00	2.179.717,00
1	0	I. НЕМАТЕРИЈАЛНИ СРЕДСТВА	112				0,00
010,011,012 и 015		II. МАТЕРИЈАЛНИ ДОБРА И ПРИРОДНИ БОГАТСТВА	113				0,00
3	020 и 020а	III. МАТЕРИЈАЛНИ СРЕДСТВА (115 ДО 121)	114	1.781.154,00	2.766.575,00	586.858,00	2.179.717,00
4	021 и 029 д	Градожни објекти	115				0,00
5	022 и 029	Станови и деловни објекти	116				
6	023 и 029 д	Опрема	117	1.781.154,00	2.766.575,00	586.858,00	2.179.717,00
7	024 и 029 д	Повеќегодишни насади	118				
8	025 и 029	Основно стадо	119				
9	028 и 029 д	Други материјални средства	120				
10	030	Аванси за материјални средства	121				
		III - 1. МАТЕРИЈАЛНИ СРЕДСТВА ВО ПОДГОТОВКА	122				

Ред.бр	Група на сметки, или сметка	ПОЗИЦИЈА	Ознака на АОП	Износ			Нето (6 - 7)
				Претходна состојба (почетна состојба)	Бруто	Исправка на вредноста	
1	2	3	4	5	6	7	8
1	2	3	4	5	6	7	8

